

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXIII i botimit, nr. 264, Tetor 2025

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Viti 2025, 100-vjetorit të lindjes së Albanologut Martin Camaj "Nderi i Kombit" dhe "Qytetar Nderi" i qytetit të Shkodrës



Homazh për veprën, jetën dhe kontributin e vyer të Luigj Shytit

2

Gazetari Sportive, arti që mbetet trashëgim

Shkodra, qyteti që i ka dhënë Shqipërisë legjenda sporti, talente të pashtershme dhe dashuri të pamatë për futbollin e për sportin në përgjithësi, në një ditë të veçantë u bë skenë e një ceremonie të mbushur me ndjenja, mirënjohje e solemnitete. Stadiumi "Loro Boriçi", ky tempull ku jehona e golave, brohoritjet e tifozëve dhe dhimbja e humbjeve kanë gdhendur historinë e qytetit, u përfshi nga një atmosferë krejt ndryshe: nga një homazh i madhërisht për ata që me penë e mikrofon e bënë sportin jo vetëm një sport por edhe rrëfim, kujtim, art.

7

Proza e Martin Camajt

Përshkruar prej një filli ku zë vend tematika prej Shqipërisë së Veriut, malësori autoritar i pathyeshëm dhe i pavarur, trim, mikpritës dhe i urtë, krenar, i flijueshëm, shpesh me jetën e tij tragjike, janë edhe novelat e Martin Camajt. E pra vargu i novelave "Pishtarët e natës", "Shkundullima", "Katundi me gjuhë të fshehtë", "Rrunga në mars", "Gjon Gazulli", që i japin dimensionin e plotë novelistikës së Camajt spikasin për natyrën e veçantë krijuese, ku bota e brendshme shpirtërore, marrëdhëniet etnokulturore dhe tradicionale, bota e tij psikologjike ndërthuren me një fill artistik, ku ndërmjetshëm mjeshtërisht simbolika me realitetin e përsëritshëm e marrin përmasa mitike.

8



Shkolla nuk është vetem zbatuese e urdhërave, por matëse e rezultateve të mësimdhënies dhe edukimit

12

Zhvillimi i vrullshëm i shoqërisë së sotme si dhe rritja me ritme marramëndëse e shpërndarjes së informacionit të pafund, kanë bërë që mësimdhënia të ndryshojë. Shkolla është bërë një institucion dinamik që po ndryshon shumë nga parametrat e saj të së kaluarës. Ky proces ndryshimi lidhet ngushtë jo vetëm me kontekstin ku ajo zhvillohet, por falë kohës së sotme e karakterizuar nga një globalizim gjithnjë e më i shpejtë që ndikon në rishikime të vazhdueshme të saj.

Homazh për veprën, jetën dhe kontributin e vyer të Luigj Shytit

Më 19 tetor 2025, në ambientet e Bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi”, me mbështetjen e Rektorit të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Prof. Dr. Tonin Gjuraraj dhe kujdesin e personelit të kësaj biblioteke, me në krye Drejtoreshën, zj. Aleketa Bekteshi u zhvillua ceremonia përkujtimore në nderim të mësuesit, publicistit, studiuesit dhe fotografit të shquar, Luigj Shytit, me rastin e njëvjetorit të ndarjes së tij nga jeta, e organizuar nga Shoqata At-dhetare “Dukagjini” në bashkëpunim me familjen Shyti.

Kjo veprimtari mblodhi së bashku personalitete të jetës akademike, kulturore dhe publike, miq, kolegë, bashkëpunëtorë dhe dashamirës të figurës dhe veprës së tij.

Ceremonia u hap nga Suela Ndoja, anëtare e kryesisë së Shoqatës “Dukagjini” dhe njëherazi drejtuesja e kësaj veprimtarie. Ajo përshëndeti të pranishmit, mes të cilëve përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe akademike, si: Kryetari i Shoqatës At-dhetare “Dukagjini”, z. Ndue Sanaj; familjarët e Luigjit; Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, z. Edmond Ndou; Konsulli i Nderit i Republikës së Austrisë në Shkodër, z. Gjergj Leqeja; Drejtoresha e shkollimit në Shkodër, zj. Briselda Kadia dhe përfaqësues të pushtetit vendor, shoqatave kulturore dhe kolegë e miq të shumtë.

Në vijim të hapjes solemne, të pranishmit qëndruan në një minutë heshtje në nderim të figurës së Luigj Shytit, duke përkujtuar me respekt dhe mall kontributin e tij të çmuar në fushën e arsimit, publicistikës dhe kulturës shqiptare. Gjatë gjithë ceremonisë, në ekranin e vendosur në sallën e bibliotekës u transmetuan pamje nga jeta dhe veprimtaria e Luigj Shytit, të përgatitura me përkushtim nga Roza Pjetri dhe Mhill Vata.

Nderimet institucionale dhe mirënjohja publike

Fjalën përshëndetëse në hapje e mbajti z. Ndue Sanaj, kryetar i Shoqatës At-dhetare “Dukagjini”, i cili vlerësoi Luigj Shytin si një ndër figurat më me dinjitet të arsimit dhe kulturës në Dukagjin dhe më gjerë, që në mes të tjerave theksoi: “Sh-tronte problemin dhe hajde ta zgjidhim ose ta bëjmë bashke, kjo ishte motoja e tij. Prandaj e ndjejë veten krenar, që pata një shoke në krah si Luigji dhe punuam gjatë së bashku, rreth 22 vite pa u ndare për asnjë çast dhe me të gjithë bashkëpunëtorët së bashku arritëm jo pak tregues në shërbim të bashkësisë së Dukagjinit kudo ata janë dhe bashkësisë së Shkodrës deri në nivel kombëtar. Pra, them i pavdekshëm, sepse poetët nuk vdesin, burrat me vlera si Luigj Shyti, ju jeton emri në përjetësi. Ne, atje kemi thënë dhe themi - **Ka lan orën gjallë!** Sa duhet që të jetojmë në këtë jete nuk e dimë, por që të jetosh në përjetësi këtë e përcakton secili me punën, me veprën e tij jetësore”.

Më pas, Kryetari i Këshillit të Qarkut

Shkodër, z. Edmond Ndou, në një fjalim të ngrohtë dhe përplot vlerësim, i dorëzoi familjes Shyti, Zj. Gjyste Shyti, titullin “Çertifikatë e Mirënjohjes nga Këshilli i Qarkut Shkodër”, në shenjë vlerësimi për kontributin e tij të përhershëm në ruajtjen e identitetit kulturor dhe historik të trevës, që në mes të tjera theksoi: “Sot, me respekt e mirënjohje, u mblodhëm për të kujtuar dhe nderuar figurën e shquar të arsimit dhe publicistikës, z. Luigj Shyti, një emër që la gjurmë të thella në jetën arsimore, kulturore e shoqërore të Shkodrës dhe më gjerë. Me propozim të Shoqatës At-dhetare “Dukagjini”, si Këshill i Qarkut Shkodër e nderuam pas vdekjes me Çertifikatë Mirënjohjeje, në shenjë respekti për kontributin e tij të vyer si mësues, drejtues shkolle, publicist dhe intelektual me vizion, me motivacion: *“Për kontributin e veçantë në zhvillimin e arsimit si mësues e drejtues i disa shkollave, në Qarkun e Shkodrës. Për veprimtarinë e frytshme si sekretar i shoqatës at-dhetare “Dukagjini” dhe kryeredaktor i gazetës “Dukagjini”, si dhe për krijimtarinë e pasur poetike, pub-*

licistike e studimore, që pasqyron vizion të gjerë kulturore dhe frymë evropiane”

Z. Shyti ishte një njeri i dijes, i kulturës dhe i përkushtimit qytetar, që me fjalën e tij të mençur dhe penën e tij fisnike frymëzoi breza të tërë.

Nderim për jetën dhe veprën e Luigj Shytit, një mësues i përkushtuar, një intelektual i ndritur, atdhetar i vërtetë dhe një familjar model.

Prezantimi i veprës dhe personalitetit të Luigj Shytit

Pas nderimeve institucionale, ceremonia vijoi me një seri prezantimesh nga studiues, poetë, arsimtarë dhe figura publike, të cilët sollën reflektime dhe analiza të thelluara mbi krijimtarinë dhe trashëgiminë e Luigj Shytit.

Poeti, historiani dhe studiuesi z. Prele Milani bëri një interpretim të thellë të veprës së tij, duke vënë në dukje cilësitë unike të mendimit dhe stilit të Shytit.

Pas tij, zj. Briselda Kadia - Truma, drejtore e Zyrës Lokale të Arsimit, ndau me të pranishmit reflektime dhe vlerësime

për punën dhe përkushtimin e Luigj Shytit në arsim.

Një vlerësim të veçantë mori edhe vepra “Gjurmë, syzime etnografike në Dukagjin”, për të cilën foli inxhinieri dhe studiuesi z. Leonard Qyteza, duke nënvizuar kujtime të veçanta me autorin, meritat e tij të padiskutueshme dhe rëndësinë e kësaj pune në dokumentimin dhe ruajtjen e trashëgimisë sonë kulturore.

Si anëtare e Kryesisë së Shoqatës At-dhetare “Dukagjini” dhe si psikologe, znj. Suela Ndoja solli një analizë të veçantë për librin “Duaje emrin tënd”, duke i dhënë lexuesit çelësin për të kuptuar dimensionin human, psikologjik dhe etik të autorit.

Mësuesja në pension, znj. Syka Çarku, në mungesë të saj e përfaqësuar nga aktivistja e dalluar e shoqatës atdhetare “Dukagjini”, Znj. Roza Pjetri, solli vlerësime mbi poezinë e përmbledhur në vëllimin “Etje”, duke prekur me ndjeshmëri botën shpirtërore dhe estetikën poetike të autorit.

Poeti Lulash Brigja foli për profilin, jetën plot vlera të Luigj Shyti vlerën do-



kumentuese dhe gjuhësore të librit “Fjalë e shprehje popullore në Dukagjin”, si një pasuri e çmuar për gjeneratat.

Në fund të këtij seksioni, mësuesi në pension z. Prele Shytani prezantoi romanin “Blerta”, duke ndarë me pjesëmarrësit elementë domethënës nga struktura dhe mesazhet që përçon kjo vepër e rëndësishme.

Momenti i reflektimeve

dhe opinioneve nga figura të shquara

***Ndoc Logu**, ndonëse fizikisht i munguar, përcolli mendimet e tij përmes **znj. Life Hasa**, duke e cilësuar Luigj Shytin si një **urë lidhëse mes brezave**, një model qytetar me përkushtim të jashtëzakonshëm ndaj dijes dhe komunitetit.

***Frashër Racaj**, Sekretari i shoqatës “Martin Dreshaj”, me qendër në Pejë dhe Kryetari i shoqatës “Lëvizja për Shqipërinë e Bashkuar”, përfaqësues i shoqërisë civile dhe njohës i thellë i vlerave kombëtare, **vlerësoi maksimalisht figurën e Luigj Shytit**. Ai ndau me të pranishmit aktin e veçantë të nderimit që shoqata e tij i kishte atribuar përmes një **titulli nderi**, “Mirënjohja e shoqatës Martin Dreshaj”, i cili iu dorëzua djalit të tij gjatë kësaj ceremonie.

Ai theksoj: Përvjetor ku ndihet mungesa jote Luigj Shyti! Krenar që bashkëpunuam më vite dhe le mbresa të thella në të gjitha pjesët e atdheut. Shoqata e Vëllazërisë Kosovë - Malësi e Madhe “Martin Dreshaj” mori pjesë në akademi-

në përkujtimore, me rastin e një vjetorit të shkuarjes në Amshim të sekretarit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” z. Luigj Shyti. Nga Shoqata morën pjesë kryetari Ukshin Jashari, sekretari i përgjithshëm i Shoqatës z. Frasher Racaj, anëtarët e Shoqatës Bekë Demaj dhe Fazli Jashari.

Shoqata e Vëllazërisë Kosovë - Malësi e Madhe “Martin Dreshaj” në Pejë, më datën 17-10-2025, me propozim të anëtarëve të Kryesisë merr vendim: Nr. 2015/25 të nderon më titullin “Mirënjohje” pas-vdekjes z. Luigj Shyti, me motivacion: “Për Kontributin e çmuar në bashkëpunimin dhe forcimin e Lidhjeve Vëllazërore në mes të dyja Shoqatave”

***Prof. Dr. Vuksan Kola**, mjek dhe personalitet me kontribute të shumta në fushën humane dhe kulturore, përmes fjalës së përcjellë nga **arsimtarja zj. Dukate Bregu**, solli vlerësime të veçanta për **rolin e Luigj Shytit si një figurë që ndërthurte shpirtin human me misionin kulturor**.

*Poeti **Lazer Kodra**, ish-kryeredaktor i gazetës “Dukagjini”, vuri në dukje **kontributin e jashtëzakonshëm të Shytit në pasurimin e mendimit publik**, si dhe në **forcimin e gjuhës së shkruar shqipe**. Ai e cilësoi Shytin si një **mësimdhënës i palodhur dhe zë i përhershëm i Dukagjinit**.

“Çdo fjalim u prit me duartrokitje të ngrohta dhe përcolli emocione të thella tek të pranishmit, të cilët e përmbyllën me urimin: ‘I përjetshëm qoftë kujtimi i

tij.”

Mbyllja e ceremonisë dhe falënderimi i familjes

Në përmbyllje të kësaj dite përkujtimore, familja Shyti – përfaqësuar nga zonja Gjyste Shyti– shprehu mirënjohje për nderimin dhe për respektin që iu bë figurës së Luigjit. Fjalët e tyre të përzierme të përçollën emocione dhe prekën zemrat e të gjithëve.

Ceremonia u mbyll me një foto përkujtimore para shkallëve të bibliotekës, si kujtim për këtë ngjarje të rëndësishme dhe për të përjetësuar nderimin ndaj një njeriu që jetoi me idealet e dijes, kulturës dhe dashurisë për vendlindjen.

U përgatit nga:

SUELA NDOJA, anëtare e kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”



Luigj Shyti - zëri, që na mungon!



Në zemrën e thellë të Alpeve shqiptare, atje ku retë përkulen mbi majat e bardha e ku shpirti i njeriut rritet bashkë me shkëmbin, u lind një djalë që do të bëhej më vonë zëri i kujtesës dhe i dritës. Në hijen e maleve të Thethit, në përroin që flet e në gurët që ruajnë histori, u rrit Luigj Shyti një mësues, një studiues, një poet, një qytetar i ndershëm, një dashamirës i pafund i vendit të tij. Në atë krahinë të lartë, ku jeta është sfidë dhe bekim njëherësh, ai mësoi qysh në fëmijëri se njeriu vlen sa fjala dhe puna e tij. Në çdo hap të jetës, në çdo fjalë që shkroi, në çdo brez që edukoi, ai la dritë e kujtesë. Si koleg dhe bashkëpunëtorë për mbi 20 vjet Luigj Shytin e kam parë dhe e vlerësoi në këto plane

Fëmijëria në gjirin e maleve – ku njeriu rritet bashkë me gurin: Thethi nuk ishte për Luigjin vetëm vendlindje, por shkollë e parë, një libër i hapur i jetës. Ai e përthithi natyrën si frymëmarrje, dëgjoi përrënjtë që i tregonin legjenda dhe preku me duar historinë që jetonte në çdo gur. Në një familje fisnike, me rrënjë të thella në Dukagjin, ai u edukua me besën, nderin dhe dashurinë për dijen. Mësimet e para ia dha vetë jeta: përlësia përballë natyrës, krenaria për origjinën dhe ndjenja e përkatësisë ndaj trungut të vet. Në shpirtin e tij u ngjiz një dashuri që nuk

do ta braktiste kurrë: dashuria për vendin dhe për fjalën.

Natyralisti që e kuptonte jetën në rrënjë: Që në vegjëli, Luigji u lidh me çdo gjë që lëvizte, frymonte dhe gjallonte. Ai nuk e shihte natyrën si sfond të bukur, por si burim jete dhe mësimi. Në çdo gjethe ai lexonte një libër, në çdo insekt një mister, në çdo burim një lutje. Kur nisi studimet në biologji e kimi në Institutin Pedagogjik të Shkodrës, ai s'po mësonte thjesht shkencë, po thellonte lidhjen me jetën vetë. E kuptoi se çdo qenie, çdo rrjedhë uji, çdo pikë drite ka vendin e vet në këtë univers, dhe se njeriu, për ta kuptuar botën, duhet më parë ta dojë atë. Kjo dashuri për natyrën u shndërrua në dije, kjo dije në mësim, e ky mësim në kulturë e ndërgjegje qytetare.

Mësuesi dhe drejtuesi që mbolli dritë: Kur hyri për herë të parë në klasë si mësues, Luigji nuk mbante vetëm një ditar, por një mision. Ai e dinte se fëmijët nuk presin vetëm mësim, por shembull. Në klasat e tij, përveç shkencave, mësohej ndërgjegjja, dashuria për vendin, respekti për njeriun dhe për punën. Si drejtor shkollash në zonat e mallnueshme të Dukagjinit e më pas në Shkodër, ai ndërtoi institucione që ishin jo vetëm vende mësimi, por edhe vatra drite dhe dinjiteti. Rendi, pastërtia, disiplina, por mbi të gjitha dashuria për nxënësin, ishin themeli i punës së tij. Në çdo vend që shkelte, linte pas një shenjë, një frymë, një kujtim të mirë. Ishte nga ata njerëz që nuk ngrinin zë, por ngritnin vlera.

Publicisti dhe studiuesi i shpirtit të Dukagjinit: Kur fjala e tij doli përtej mureve të shkollës, ajo mori trajtën e fjalës publike. Në gazeta, revista e botime, Luigj Shyti u bë zëdhënës i një krahine, i një kulture dhe i një brezi. Shkroi me ndjenjë dhe me dije, me penë të qetë, por me shpirt të zjarrtë. Në çdo shkrim të tij gjendet përpjekja për të ruajtur kujtesën, fjalën, zakonet, frymën e njerëzve të mirë të Dukagjinit.

Vepra e tij është e shumanshme e

thellë: Publicistika e Luigj Shytit është mbushur me reflektime mbi njeriun e sotëm ("Dukagjini ka vend për të gjithë" dhe "Duaje emrin tënd"); Etnografia dhe historia, si "Gjurmë", "Dukagjini, rrugëtim në gjenezë", "Fjalë të rralla"; Poezia, ku ndjenja e natyrës dhe e shpirtit bashkohen ("Moj e mira nortek të borës", "Etje", "Lamtumirë mos thua", "Blerta"); Arsimit dhe kultura, përmbledhur në veprën monumentale "Historik i arsimit dhe kulturës në Dukagjin", ku një shekull i tërë përpjekjesh për dritë është skalitur me kujdesin e një kronisti të ndërgjegjshëm. Në çdo faqe të këtyre librave, njeriu ndien peshën e dashurisë për vendin dhe mallin e heshtur për një kohë që s'kthehet.

Si ruajtësi i kujtesës kolektive dhe figurave të shquara: Luigji nuk shkruante për t'u lavdëruar. Ai shkruante për të ruajtur kujtimin, për të lidhur brezat, për të mos e lënë harresën të mbulojë njerëzit e dritës. Falë përpjekjeve të tij, u ngritën bustet e Mehmet Shpendit dhe Martin Camajt, dy figura që ai i deshi dhe i nderoi si bij të vërtetë të maleve. Ai hulumtoi me pasion lidhjet e At Shtjefën Gjeçovit dhe Gjeçajt duke krijuar ura të reja ndërmjet historisë dhe shpirtit të kombit. Në çdo studim të tij, fshihet një pyetje e madhe, një mall i thellë: "A do të dimë ne t'i ruajmë ata që na dha kujtesë, Luigji intelektual ynë i shoqërisë, i veprimit dhe i ndihmës."

Si Sekretar i Shoqatës "Dukagjini" për 15 vjet, ai ishte tiktaku dhe zemëreku i saj i gjallë: Luigji ishte jo zyrtar i ftohtë, por shok, këshilltar, frymëzues, veprimtarë i devotshëm dhe human, shembull që duhet ndjekur. Në çdo aktivitet letrar, në çdo takim, në çdo promovim, ai ishte aty, me një buzëqeshje të qetë dhe një fjalë që të mbetej në mendje. Ai lidhte njerëz, ide, breza, ndihmonte pa u dukur, organizonte pa zhurmë, udhëhiqte pa imponim. Nëpërmjet Klubit "Pena e Shkodrës" frymëzoi të rinjtë, duke u mësuar se fjala është mjet drite, jo thikë. Edhe fotografia për të ishte art dhe kujtesë. Në çdo

imazh që kapte, kishte një copë dhimbjeje dhe bukurie, një ndalesë kohe që fliste më shumë se një fjalim. Në çdo vepër, në çdo rresht e në çdo pamje, Luigj Shyti përsëriste urtësinë e vet të thellë: "Mos e harro kush je dhe nga vjen."

Zbrazëtia që la – një boshllëk që nuk mbushet me heshtje: Kur më 20 tetor 2024, në Torino, ai mbylli sytë, nuk u shua vetëm një njeri, por një dritë që ndriçonte shumë zemra. Largimi i Luigjit la një boshllëk që s'e mbush dot as fjala, as ceremonia. Sepse kur ikin njerëz të tillë, ikin fjalorë të tërë jete, ikin kujtime që s'janë shkruar askund tjetër veç në shpirtin e njerëzve. Është e dhimbshme të thuhet, por e vërtetë, asnjë institucion nuk e vlerësoi sa duhej, as në gjallje, as në ndarje.

Por ai nuk punoi për mirënjohje: Ai punoi për brezat që do të vijnë, për kulturën që duhet të qëndrojë, për kujtesën që s'duhet të shuhet. Në një kohë ku shpesh ngrihen në piedestal mediokriteti dhe fasada, Luigj Shyti mbeti i heshtur në madhësinë e tij, si një mal që s'ka nevojë të flasë për të treguar lartësinë.

Sot, kur kujtojmë fjalën e tij, ndiejmë një mall të butë, një nostalgji që digjet ngadalë si prushi nën hirin e kujtesës. Luigji Na mungon jo vetëm si studiues, por si njeri, si frymë, si qetësi.

Ai është një kujtim që bëhet dritë: Luigj Shyti nuk ishte vetëm një autor librash, as vetëm një mësues apo drejtues arsimit. Ai ishte një mënyrë të menduari, një praktikë të jetuari dhe model vullnetarizmi. Në çdo fjalë të tij ndihet dashuria për vendin, mall për njerëzit e punës, respekt për të shkuarën dhe besim tek e ardhmja.

Sot, kur ai s'është më, mbetet fjala e tij si udhërrëfyes i heshtur, si dritë që nuk shuhet në terrin e harresës.

Në kujtimin tonë, Luigj Shyti mbetet një kristal i pastër i Dukagjinit, një frymë që do të vazhdojë të jetojë në çdo brez që di të dojë tokën, dijen dhe njeriun.

Në fund të fundit, ka njerëz që nuk ikin. Ata kthehen në zëra që na mungojnë përditë. Dhe Luigj Shyti është njëri prej tyre!

Prele Milani

Publicistikë - "Duaje emrin tënd"

- Analizë psikologjike dhe portret i autorit Luigj Shyti -

Të nderuar të pranishëm, të dashur kolegë, miq dhe të afërm të autorit

Me nderim e respekt të thellë, sot kujtojmë figurën e mësuesit, studiuesit dhe autorit Luigj Shyti, i cili na ka lënë një trashëgimi të çmuar përmes librit të tij



"Publicistikë-Duaje emrin tënd". Ky libër është pasqyrë e një personaliteti të nderuar mbi parime të forta etike dhe ndjenja të thella atdhedashurie. Si autor, Shyti qëndron në kufirin delikat midis fjalës së menduar dhe fjalës së ndërjerë – ku publicistika ngjall reflektim, dhe poezia prek shpirtin.

Në aspektin psikologjik, ky libër përfaqëson një thirrje për vetëdije dhe për vetë respekt. Sidomos me titullin "Duaje emrin tënd", autori na fton të reflektojmë mbi identitetin tonë personal dhe moral. Në psikologjinë zhvillimore dhe morale, emri nuk është vetëm një emërtim, por një simbol i identitetit social, familjar dhe etik. Ai mbart vlera, histori, dhe përgjegjësi – ndaj vetes dhe të tjerëve.

Në aspektin emocional, mesazhi i poez-

isë dhe publicistikës së tij është një thirrje për përgjegjësi dhe vetëdije. Ai nxit lexuesin të bëjë një introspeksion të thellë, duke pyetur në heshtje: "A e dua unë

vërtet emrin tim? A e ruaj dinjitetin që ai simbolizon?". Dëshiroj të citoj nga faqe 82 këto fjalë: "Jeta ka shumë vështirësi, kërkon punë, iniciativë, këmbëngulje, dhe vizion për tu jetuar. Është lehtë të qëndrosh në vend, të mos lodhesh, të mos interesohesh për vete, për komunitetin tënd dhe për vendin. Kujtoj këtu fjalët e një poeti rus I cili thotë s nuk është e vështirë për të vdekur, vështirë është për të jetuar" ne duhet të kërkojmë dhe gjejmë sa më shumë lidhje me njëri-tjetrin". Kjo sfidë shpirtërore është një ftesë për rigjallërimin e vetëvlerësimit dhe përforsimin e qëndrueshmërisë moral

Luigj Shyti i qaset emrit si një kod nderi: një thirrje për të jetuar me dinjitet, për të mos e njollësuar veten me veprime

që dëmtojnë integritetin personal. Kjo i jep veprës një dimension edukativ dhe psikoterapeutik, sepse i drejtohet ndërgjegjes së individit, duke i rikujtuar atij se dinjiteti nuk është i dhënë, por fitohet dhe mbrohet çdo ditë. Kjo është një mënyrë e të shkruarit që përkon me qëndrimin e autorit në jetë – i ndershëm, i përmbajtur, dhe i palodhur në shërbim të vlerave.

Në pjesën publicistike të librit që janë përmbledhje të të gjitha kumtesave që ka mbajtur nëpër veprimtari e vende të ndryshme si Shqipëri, Kosovë e më gjerë, hasim një tjetër dimension të tij – ai i njeriut qytetar, që ndjen dhe mban përgjegjësi për realitetin ku jeton. Ai shfaq shqetësim për humbjen e masave etike në shoqëri, për deformimin e parimeve dhe për harresën që i kanoset historisë sonë kulturore. Artikujt e tij nuk janë ftohtë analitikë; përkundrazi, janë të gjallë, të drejtpërdrejtë dhe mbartin një zë të ndershëm që nuk shitet dhe nuk hesht.

Personaliteti i Luigj Shytit, ashtu si ve-

Luigj Shyti, thethjani shkodran!



Një ftesë nga Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, bashkë me familjen e Luigj Shytit, na ka tubuar në këtë takim përkujtimor për veprën e tij letrare dhe studimore, në 1 vjetorin e ndarjes nga jeta.

Bëhen vite që më udhëheq thënja e një sipërmarrësi gjerman të funeraleve, ai thotë:

“Vdekjen tëndë vetëm e vdes.

Vdekjen e të tjerëve duhet ta jetosh!”

Sot, duhet të përjetojmë jetën e Luigj Shytit përmes vepra që na ka lënë, kujtimet e tij në mesin e të gjithëve që e njohën, që jetuan me të.

Edhe unë kam disa kujtime me Luigjin, jo vetëm disa shëtitje e kafe në Piacë, por edhe në librat e tij.

Kam tre libra që më ka dhuruar, me dedikimin e tij: Z. Leonard Qyteza – me respekt Luigj Shyti - dhe mbajnë datën 19 mars 2019 (“Dukagjini” dhe “Moj e mira n’ortek t’borës”, po kështu edhe “Gjurmë”).

Në parathënjën e librit “Moj e mira n’ortek t’borës”, shkrimtari dhe një mik i Luigjit, poeti dhe publicisti Paulin Shtjefni, shkruan, ...”ky botim i birit të zgjuar të Thethit e Dukagjinit, Luigj Shyti, i shtohet botimeve të tjera të tij dhe disa dukagjinase të urtë dhe të ditur, që me shumë dashuri dhe respekt kanë shkruar dhe po shkruajnë për vendlindjen e tyre të shtrejtë, për Dukagjinin e punës, luftës dhe të këngës”.

Me Luigj Shytin më lidhin edhe kujtime e biseda në mes vedit, bie fjala, ai shkruan për mua:

“Lexova një mesazh të shkruar nga

Leonard Qyteza me 23 gusht 2018, pas një ripublikimi të tij po nga Leonardi. U ndjeva fajtor, që nuk e kisha lexuar më parë, jo sepse do të ndryshonte asgjë, por thjeshtë për konsideratën dhe respektin që ai ka treguar në atë shënim të bërë, pas një vizite në Bujtinën e Kol Gjoni nga Rragami i Shalës. Po e kopjoj besnikërisht, për ata që e kanë të vështirë që ta lexojnë në foto: “23.8.2018

Njëqind herë të vi në Valbonë, vetëm të Kol Gjoni do të bujtoj, vetëm këtu ndihesh si në shtëpinë tande, vetëm këtu shqiptaria merr kuptim. Faleminderit!”

Leonard Qyteza Shkodra (firma).

Mandej, Luigji shkruan: “Nuk ka ma bukur, më mirë, më thellë. Pa fjalë të mëdhaja, bombastike, të kopjuara nëpër libra a dikun tjetër, por thjeshtë natyrshëm si e vërteta që është. Më vjen mirë që një kushri imi në katër brez shkruan kaq bukur për një tjetër kushri po në katër brez. Kështu mund të shkruaj vetëm një djalë, një burrë, një intelektual virtuoz dhe një shok i mirë si Leonardi. Faleminderit Nardi!”

Përgjigja ime, 26.8.2020.

I dashtun Luigj Shyti!

Më beso, pa sforco, pa mendu gjatë, mora lapsin e shkruajta çfarë më diktoj zemra.

Po ta shikoni Librin e Përshtypjeve që Kola e mbanë në sallën e pritjes së miqve, janë disa libra të mbushur nga të huaj e vendas, janë disa herë më shumë se, përshtypjet e “rinisë komuniste” në ish muzeun ateist të Shkodrës, që sot ruhen si relike. Arsyeja, sot shkruhet me zemër, atbotë me stomak bosh, ...prej hallit.

Të përshendes, dhe sëbashku me burrat thethjanë të Coloseut, të ftoi për kafe. Tung!

Unë sot, po ja kthej: “T’falem nderës Luigj, edhe aty ku prehësh”!

Edhe diçka tjetër me Luigjin.

Disa vite më parë, shkruajta një shkrim në Facebook, - “Gjyshja ime Lina”, dhe bëhej fjalë për atë plakën e bukur Linë Ujkja Vata, gruaja e Bash Vata i Vat Loshit-Gjelaj, e cila në vitin 1943, pasi i vdiq i shoqi, mori tri çikat e veta, vajza të bukura dhe rá në Shkodër, dhe kthehej në Theth për verime e kujtime. Luigji, pasi e

lexoi shkrimin mu lutë ta merrte për gazetën dinjitoze “Dukagjini”, kryeredaktor i së cilës ishte, dhe e botoi.

Librat e dhuruar nga Luigji, i kam lexuar sapo i shfletova për të parë përmbajtjen dhe materialet e trajtuara në to. Më bani shumë përshtypje libri “Dukagjini”- rrugëtim në gjenezë - një libër që duket se Luigjin e ngacmonte, ndaj ai i vendos një qëllim shkrimit të librit, “Kudo që të jeni e ngado që të shkonit, vendin dhe prejardhjen tuaj kujtoni”, sepse librin ja kushton fëmijve të tij.

Një libër studimor gjatë një rrugëtimi si dëshmitar i kohës që jetoj, rreth atyre që dëgjoi, që lexoi, që i pa, si ajo thënja cezariane : “VENI, VIDI, VICI (erdha, pashë, fitova)! Luigji ishte skrupuloz, vetëm te ky libër, ai përdori bibliografinë e 147 autorëve vendas e të huaj, duke ju referuar në mbi 1000 faqe të konsultuar, sepse ai vetë thotë: ai që di kush është e nga vjen, di ku shkon e çfarë kërkon”!.

Libri në fjalë, për një lexues të censhëm, është një manual, një hartë rruge për të ditur shumë për Dukagjinin dhe Thethin në veçanti dhe, siç thotë redaktori dhe konsulenti i librit, Prof.As.Dr. Zef Gjetja, “Luigji me këtë libër ka arritur dy gjëra shumë të rëndësishme: e para, na ka sjellë një botim mjaft dinjitoz, të arrirë dhe interesant për fushën që ka studiuar, dhe së dyti, ky botim mund dhe duhet të shërbejë si një nxitje për hulumtime të mëtejshme në këtë fushë”.

Jeta familjare në rininë e tij, shkollimi në kushte të vështira, sapo mbaroi shkollën 7vjeçare ju fut punës në kooperativën bujqësore, direkt në bujqësi. Punonte sa kishte mundësi, ishte shumë i disiplinuar dhe krijonte marrëdhënie shumë të mira me të gjithë pjesëtarët e tjerë me të cilët i takonte të punonin bashkë, mandej, mbarimi i shkollës së lartë dhe fillimi si mësues për lëndën bio-kimi, i sollën Luigjit një rrugëtim të gjatë e të bukur duke lënë gjurmë të pashlyeshme.

Për këto “Gjurmë”, ai shkruan librin e tij me “syzime etnografike në Dukagjin” në vitin 2007, me dedikimin:

“Me dashuri Gjyestes,

Shoqja ime e jetës”.

Një libër me fjalë dhe frazeologji të rralla, mobiljet dhe orenditë dhe emërtimet e tyre, veshjet, rritet në gëzime dhe hidhërime, veglat e punës, toponimet, kullat e ngujimit, gjeneza, besimi fetar, janë historia e gdhendur, janë pasuri etnografike dhe etnokulturore që sot më shumë se kurrë, duhet të rikthehen në kujtesën e brezit të ri që jeton në Dukagjin dhe zhvillon turizmit kulturor, gastronomik, të ecjeve në kalimin e shtigjeve dhe libri i Luigjit “Gjurmë”, duhet të ribotohet, ndoshta edhe me sponsor e të jepet qoftë edhe falas në çdo Bujtinë, në mënyrë që, edhe vetëm me fotot e shumtë në libër, ti thuhet turistit, se në faqet e këtij libri janë mbi 500 fjalë e shprehje të rralla, e shumë të rralla, gjithashtu, janë evidentuar 115 lloje buke e ushqimesh dhe 402 enë, orendi e mjete të përdorimit në Dukagjin, nga jeta në këto male.

Dukuritë negative që vihen re në kushtet e një zhvillimi të vrullshëm e kaotik që ka marrë turizmi malor në këto kohë, moderniteti ynë që nuk josh asnjë turist por modestia e tyre, e pranon apriori, mungesa e një jete baritore, punimi i tokës, pemët frutore, kosherët e bletëve që mungojnë aty-këtu, parmenda e vjetër që mungon, tharku i dhiut, rrethimet e oborreve me dru e thupra në vend të rrjetave metalike industriale, mjetet e përdorimit familjar si, tundësi i qumështit, mjelca, bulera, tpini, kazani i rakisë, sofrat dhe stolat me

tri këmbë, djepi, kusia në vargonjë, kali i druve, opingat prej lekurës së lopës, mjelja e lopës, koshi i misrit, çiftelia dhe lahuta e të tjera orendi të dikurshme, që Luigji i sjell në libër, duhet të ripërtihen dhe të sillen në syrin dhe veshin e turistit, jam i bindur se shumë sosh, janë në shtëpitë dukagjinase të qytetit ku jetohej sot. Po, pse nuk bëhen dasma në pikun e verës në Theth, në sytë e turistit, madje, edhe në Bujtinën tande ku po pushojnë turistë vendas dhe të huaj, se është ma bukur se në Shkodrën e bujshme e shurdhuese me buria, bile për ndonjë që mund të harronte për një moment, Luigji ja kujton në libër, shpotine popullore thumbuese:

“....u harrova hamë dreq pushkën

Se 500 lekë duhen për

krushkën....”

Dhe, nusja e dhëndrri të veshur me kostume popullore, ashtu si në foton në libër, Lulë Demja e Lekë Marshi nga Dukagjini, në vitin 1903.

Sot, Thethi në mënyrë të veçantë po kalon disa momente të vështira të zhvillimit e të ecjes së tij në një stad të pranuar për ndërtimet e bujtinave me kriteret e tjera nga ato që ishin trashëguar, jo se ato ishin të pa bukura për ne, por koha kërkon hap-sira dhe kushte, të kohës për një turizëm cilësor. Thethi nuk don tritol e fadroma, por projekte të mirëfillta ndërtimore dhe arkitektonike, të mbështetura në traditën e hershme të parëve tonë, ato ishin mjeshtra të mirëfilltë, të përmendi njërin, që e kam njohur dhe e kam “gjetë”, mjeshtrin Llesh Prela i Prel Alisë. Luigj Shyti në librin e tij në fjalë, shkruan për banesat karakteristike në Theth, çdo arkitekt këto shënime duhet ti marrë si detyrë projektimi.

Edhe mulliri i Gjeçajve dhe ai i Kolajve duhet të ndreqen e të funksionojnë qoftë edhe në shërbim të turizmit, Luigji shkruan për to dhe jep spjegime edhe për brezin e ri sot, si funksionim dhe mënyrën dhe rregullin për kohën e bluarjes dhe ujitjen e bimëve, rregulli është “mulliri ndalet dhe ara ujitet” duke arsyetuar se po nuk prodhove nuk ke çfarë të bluash.

Në libër jepet me hollësi mënyra dhe mjetet për përbalimin e borës në male, disa faqe krejtë të qarta dhe të vlefshme, se sot jetohej edhe në dimër atyre anëve.

Vend të veçantë dhe me shumë detaje, jepet edhe ceremonia mortore, që është një traditë shekullore e maleve tona. Luigji është i vertetë në përçimin e traditës dukagjinase.

Si përfundim, shkruhet në parathënjën e librit, ...“autori me anën e këtij libri i ka sjellë lexuesit vlera të etnokulturës së këtij populli (deri në fillimet e shekullit të XXI) që janë dëshmi e qëndresës së tij etnike dhe rrugës së gjatë të zhvillimit përmes furtunave të ashpra të shekujve”.

Në përfundim, me dëshirën time, që shpirti fluturës i Luigjit në Amshim të më ndigjojë, po shkëpus diçka nga At Zef Valentini “KUR U ÇIL RRUGA E THETHIT” dhe po i vendos në kumtin e Luigj Shytit që buron nga librat e tij: “Aman, tregtarë; aman malësorë; ne mos ju dhimbte vendi, së paku vedin mos e fikni, sikurse njaj qi per të rrxue një landë mbë spatë i bje vedit nenit të kambës”.

Leonard Qyteza, sot, 19 tetor 2025.

pra e tij, ndërthur urtësinë me guximin, ndjeshmërinë me arsyen. Ai nuk flet me zë të lartë, por me peshën e fjalës. Ai nuk imponohet, por frymëzon. Si mësues, edukoi breza me fjalë dhe me shembull. Si autor, vazhdon të edukojë edhe sot – përmes veprës që lë pas.

Në përfundim, libri “Publicistikë– Duaje emrin tënd” është një pasuri shpirtërore dhe morale. Ai është një ftesë për të mos e harruar kush jemi, për të mos e harruar “emrin tonë” – jo vetëm si individë, por si njerëz me histori, me rrënjë dhe me detyrë për të ruajtur atë që kemi më të shenjtë: ndershmërinë, kujtesën dhe karakterin.

Në një botë që shpesh sfidon vlerat tona, mesazhi i tij mbetet aktual dhe i fuqishëm: të duash emrin tënd është të duash veten, të mbrosh veten dhe gjithçka që përfaqëson. I përjetshëm qoftë kujtimi i tij.

Faleminderit.

Përgatitur nga: Dr. Suela Ndoja

Krenari, që të patëm, dhimbje sepse na mungon...



Kështu do ta përkufizoja unë këtë veprimtari përkujtimore për mikun tonë të pavdekshëm, intelektualin dukagjinas Luigj Shyti.

Them "i pavdekshëm", sepse poetët nuk vdesin. Burrat me vlera si z. Luigj Shyti, u jeton emri në përjetësi, sepse krenaria për jetën dhe veprën e tij është më e madhe se dhimbja.

Ne atje në Dukagjin kemi thënë dhe themi: "Ka lan orën gjallë", dhe vërtet Luigj Shyti e ka lan orën gjallë.

Për secilin nga ne, se sa duhet të jetojmë në këtë jetë, këtë e përcakton Zoti, por që të jetosh në përjetësi, këtë e përcakton secili me veprën e tij jetësore.

Dukagjini ka përcjellë me krenari, por para kohe, edhe personalitete të tjera që në respektin dhe kujtesën e popullit kanë mbetur të pavdekshëm.

Këtu mund të kujtoj profesorin Prel Bregu apo Dr. Prel Gjeloši

Por intelektual Luigj Shyti ishte një vlerë e çmuar për Dukagjinin dhe një pasuri për qytetin e Shkodrës.

Prandaj thashë dhe do të them:

Krenari që të patëm, dhimbje sepse na mungon!

Nëse në kohën tonë do të kalonte një tjetër Edith Durham apo Rosa Leine për të shkruar për majat e Shalës apo për burrat e Dukagjinit, pa më të voglin dyshim, intelektualin Luigj Shyti do ta cilësonte si një nga përfaqësuesit më tipikë të gjeneve të lashta të Lekëve të Dukagjinit.

Një burrë fisnik dhe i ditur, intelektual dhe tradicional, vizionar dhe bashkëkohor, poet dhe profesor, studiues dhe publicist, fotograf dhe moderator.

Luigj Shyti ishte krenari për Dukagjinin, kudo që shkeli me këmbë dhe kudo ligjëroi me fjalë.

Nuk do të përsëris ato që i thanë kolegët parafolës.

Nuk do të flas më gjatë për opinionet e mia personale, por di të them se për rreth 20 vite tek gazeta Dukagjini dhe në aktivitetet kulturore-artistike në Shqipëri e Kosovë ka qenë një mik special dhe shembull frymëzimi.

Nga organizatorët e aktivitetit kam porosi që ta fokusoj fjalën time tek njëri nga 12 librat e tij:

"FJALË TË RRALLA DHE FJALË TË URTA TË DUKAGJINIT"

Në syrin tim është një libër i tipit "Napoleon": pak faqe dhe shumë vlera. Studiuesi Luigj Shyti kishte formimin profesional dhe intelektual për t'u marrë me studime në fushën e folklorit, historisë dhe etimologjisë, duke vazhduar në gjurmët e Shtjefën Gjeçovit apo At Bernardin

Palajt.

Profesor Luigji, me shumë pasion, na la ndër të tjera edhe një libër të tillë me vlera të çmuara për brezat.

Njerëzit e mençur dinë të lënë gjurmë me jetën dhe veprën e tyre.

Jo më kot thonë se poetët janë të pavdekshëm.

Ky libër, që ka rreth një mijë fjalë të rralla, mbi 800 fjalë të urta dhe disa qindra shprehje popullore, është një studim i mirëfillt shkencor në fushën e folklorit, gjuhësisë dhe etimologjisë.

Një libër publicistik apo artistik është kënaqësi për ta lexuar, por libri studimor e shkencor është një pasuri kombëtare dhe ia rrit vlerat autorit.

Në parathënie të librit, autori thotë:

- "E bëra këtë punë me shumë pasion, në respekt të trashëgimisë kulturore, gjuhësore dhe historike të vendlindjes sime, Dukagjin. Duke parë se njerëzit po lëvizin, brezat po ndërrohen dhe koha po ecën, nesër këto fjalë të urta dhe shprehje të rralla do të jenë objekt studimi për profesorë dhe gjuhëtarë, por edhe një mjet identiteti për trashëgiminë dhe historinë tonë."

Vetëm ai e di sa orë e sa vite pune janë dashur për një libër të tillë, sa kilometra rrugë dhe sa persona ka pyetur për të mbledhur të gjitha ato fjalë, por edhe për t'i zbrëthyer dhe argumentuar në mënyrë profesionale.

Unë jam shumë i dhënë pas fotografisë kam shëtit pothuajse të gjitha Alpet Shqiptare, por arshiva fotografike që ka

lënë z Luigj Shyti jam i bindur se është një tjetër pasuri e çmuar personazheve në arkivin "shtëpi" dhe objekte natyrore të pesëdhjetë viteve të fundit, që nuk i gjen askund tjetër jam i bindur se janë aty.

Dukagjini ka shumë autorë dhe publicistë që kanë lënë gjurmë në letërsinë shqipe, por që të njohësh këtë trevë me të gjitha ngjyrat e ylberit të saj, mjafton të lexosh krijimtarinë artistike të z. Luigj Shyti.

Unë nuk e kam ndërmend të zgjatëm apo të bëj recension libri në një moment përkujtimor letrar-artistik, por dua të theksoj mendimin tim, se poeti dhe publicisti Luigj Shyti, me jetën dhe veprën e tij, u bë i pavdekshëm.

Sidomos dy librat e tij:

"Dukagjini, rrugëtim në gjenezë" dhe "Fjalë të rralla dhe fjalë të urta", janë vërtet studime shkencore që ndër breza do të kenë vlera të veçanta.

Familja, së pari, të gjithë miqtë dhe kolegët, Shkodra dhe Dukagjini duhet të jenë krenarë për jetën dhe veprën e këtij burri, për emrin dhe kujtimin që la pas.

Kur krenaria është më e madhe se dhimbja, kur lavdia është më e madhe se jeta, unë mendoj se nuk duhet të vajtojmë, por duhet të nderojmë.

Prandaj ky aktivitet në nderim të mikut tonë Luigj Shyti, për mua ka një lajtmotiv:

Krenari që të patëm, dhimbje sepse na mungon

LULASH BRIGJA, 19 tetor 2005

Kush ishin filistinët? Jo palestinezët që janë arab



Prof. Dr. FAHRI XHARRA

Që të flasësh të vërtetën duhet të diësh, të thuash të vërtetën duhet të kesh guxim, jo të anosh për hatër të fesë, partisë, regjionit e qoftë largët nga lakmia e parasë.

Duhet bërë dallimin në mes filistinëve dhe palestinezëve, të cilët nuk kanë lidhje gjenetike ndër veti. Derisa Filistinët ishin pellazgë, palestinezët janë arabë, të ardhur në tokat filistinë në shekullin X.

Filistinët ishin një popull i vjetër, të cilët jetonin në brigjet jugore të Canaanit në mes të shekujve XII - VI para Krishtit. Ata janë njohur nga konflikti biblik me izraelitët. Gjurmët më bindëse të origjinës

së tyre janë arkeologjike dhe të drejtojnë kah deti Egje. Megjithëse, egjiptasit flasin për ardhjen e tyre nga veriu (shih hartën), gjurmët gjuhësore provojnë që ata janë të Egjeut.

Për shumë gjuhëtarë, filistinët janë identikë me pellazgët (të përmendur edhe në Iliadë). Tani në këtë huti shkencore, ishin apo nuk ishin me origjinë pellazge, është e sigurt origjina e tyre nga Egjeu.

Analizat gjenetike të skeleteve të zbuluara në qytetin e vjetër bregdetar Ashkelon, që dëshmojnë të epokës së bronzit dhe të hekurit e vërtetojnë, që filistinët të atyre dy epokave e kanë pasur edhe një pjesë të gjenomit, i cili nuk është gjetur tek mbetjet e popujve po të asaj epoke në atë regjion. Sipas hulumtuesit të Institutit "Max Planck", Michel Feldman kjo pjesë e gjenomit rrjedh prej popujve evropian.

Historiani i madh Mathieu Aref i fut

filistinët në familjen e madhe etnolinguistike të pellazgëve.

Duke e lexuar librin "Shqipja, nëna e gjuhëve" nga Xhuzepe Krispi (1831) lexojmë: "që për zanafillën e gjuhës shqipe duhet ta njohim edhe një gjuhë tjetër e lindur në atë kohë e që është hebraishtja. Kështu, kur Zoti na e dha gjuhën, ajo ishte e papërsosur me shumë kufizime, me fjalë

të shkurtra, siç shihet edhe në gjuhën hebreje, rrënjët e së cilës nuk e tejkalojnë numrin prej tri bashkëtingëlloresh. Një pikë ngjashmërie në mes të dy gjuhëve, asaj shqipe dhe hebraishte, përveç fjalëve një rrokeshje, është edhe përdorimi i shkronjës "ë".

XI	Les Pélasges
XI, 1	Pélasgos, éponyme des Pélasges
XI, 2.	Ethnonyme des Pélasges
XII	La grande famille ethnolinguistique des
XII, a	Les Illyriens
XII, b	Les Thraces
XII, c	Les Épirotes
XII, d	Les Macédoniens
XII, e	Les Étrusques
XII, f	Les Phrygiens
XII, g	Les Philistins
XIII	Conclusion
XIV	Annexes
	1- Généalogies (nombreuses et controversées)
	2- Arbre généalogique de la descendance égypto-phénicie

Gazetari Sportive, arti që mbetet trashëgim

Në kujtim e nderim të penave që frymëzuan sportin

Shkodra, qyteti që i ka dhënë Shqipërisë legjenda sporti, talente të pashtershme dhe dashuri të pamatë për futbollin e për sportin në përgjithësi, në një ditë të veçantë u bë skenë e një ceremonie të mbushur me ndjenja, mirënjohje e solemnitete. Stadiumi "Loro Boriçi", ky tempull ku jehona e golave, brohoritjet e tifozëve dhe dhimbja e humbjeve kanë gdhendur historinë e qytetit, u përfshi nga një atmosferë krejt ndryshe: nga një homazh i madhërisë për ata që me penë e mikrofonin e bënë sportin jo vetëm ngjarje, por edhe rrëfim, kujtim, art.

Muret e stadiumit sikur flisnin. Në heshtjen e tyre ndiheshen sikur ato ruanin kujtimet e çdo ndeshjeje të dikurshme, çdo heroi të fushës, çdo pasionant tifozësh. Por atë ditë, ato mure ruanin një tjetër histori, historinë e gazetarëve sportivë që i dhanë zë, ngjyrë e jetë çdo fitoreje e humbjeje, duke e kthyer sportin në një përjetim të përbashkët.

Në këtë takim të mbushur me dritë e emocion, u mbledhën bashkë familjarë, miq, kolegë dhe bashkëpunëtorë të figurave më të njohura të sportit dhe gazetarisë sportive. Çdo fytyrë bartte një shikim të qetë, të mbushur me respekt, buzëqeshje të ngrohta, por edhe një melankoli të ëmbël që e sjell vetëm kujtimi i atyre që nuk janë më. Në çastin kur Kryetari i Qarkut, z. Edmond Ndou, mori fjalën, një heshtje solemne pushtoi sallën. Në fjalën e parë të tij u kuptua se kjo nuk ishte një ditë e zakonshme: "Gazetaria sportive", tha ai, nuk është thjesht raportim. Është art, është pasion, është mision. Ajo është ura që lidh brezat, është fryma që bën të pavdekshme emocionet e sportit.

Fjalët e tij ranë si jehonë e largët, duke zgjuar kujtime e emocione. Në atë moment, u ndje sikur prania e atyre gazetarëve të shquar që nuk jetojnë më, ishte aty, e padukshme por e fortë, e pranishme në çdo duartrokasje, në çdo mendim që endet në hapësirë.

Këshilli i Qarkut Shkodër nderoi me certifikata mirënjohjeje tre gazetarë të shquar, që prej dekadash kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në gazetarinë sportive shqiptare: Ymer Stërnqi, Ramadan Bigza dhe Meidan Zhivani. Ata mbeten të gjallë në zemrat e sportdashësve, sepse veprat, kronikat dhe zëri i tyre janë shndërruar në trashëgimi të përgjithshme. Secili prej tyre ishte një kolonë që mbajti peshën e një kohe, një dëshmitar i gjallë i një epoke ku sporti jetonte përmes fjalës së shkruar e përmes mikrofonit të ndezur.

Por homazhi nuk ishte vetëm për ata që nuk janë më. Në të njëjtën ditë, u vlerësuan edhe dy gazetarë që vazhdojnë të jenë sot frymëzim për brezat e rinj: Namik Mehmeti dhe Gaspër Marku. Për dekada me radhë, ata kanë qëndruar në ballë të raportimit, kanë shkruar me dashuri, kanë folur me profesionalizëm dhe integritet, duke dëshmuar se gazetaria sportive është një rrugëtim i pandërprerë, një zjarr që nuk shuhet, por përcillet brez pas brezi.

Atmosfera ishte e mbushur me solem-

nitet të thellë. Nuk ishte një ceremoni e zakonshme: ishte një shfaqje ndjenjash, një ndërthurje e kujtimeve me respektin. Çdo duartrokasje ishte më shumë se një gjest, ishte një rrëfim i heshtur. Çdo buzëqeshje mbante brenda një histori, çdo pauzë e

drës. Ishte një udhëtim pas në kohë, një rikthim tek rrënjët.

Emocionet nuk i fshihte askush. Familjarët e gazetarëve që nuk jetojnë më e përjetuan këtë mbrëmje si një kujtim të gjallë për të dashurit e tyre. Kolegët, miqtë



fjalës ishte si një lutje. Diskutimet mes të pranishmëve sillnin jehona nga vitet e shkuara: nga kronikat e lexuara në gazetë e mëngjesit, nga zërat në radio që mbushnin shtëpitë e qytetarëve, nga shkrimet që bëheshin temë bisede në kafetë e Shko-

e bashkëpunëtorët i panë ata si shembuj të përgjithshëm që nuk humbin asnjëherë vlerën. Në fjalën e tij, z. Gaspër Marku e shprehu me thjeshtësi, por me thellësi: "Është padyshim emocion i shumtë. Ne kemi përjetuar shumë emocione në ter-

ren, duke përcjellë kronikat tona dhe duke pasqyruar figura që sot janë prezent këtu. Por kur puna dhe djersa e viteve shpërblehet, ky emocion bëhet edhe më i këndshëm. Dua të falënderoj ata që e bënë të mundur këtë nderim, Klubin e Futbollit "Vllaznia", me president z. Alban Xhaferi, si dhe Këshillin e Qarkut Shkodër me drejtuesin e tij pasionant, tifozin e madh z. Edmond Ndou. Media sportive shkodrane mbetet një ndër më të spikaturat në Shqipëri, dhe kjo është meritë e punës e përkushtimit të shumë brezave."

Në shenjë nderimi e respekti, Presidenti i Klubit të Futbollit "Vllaznia" dorëzoi fanella të ekipit si dhuratë simbolike. Ishte një gjest i thjeshtë, por i madh, sepse fanella e "Vllaznisë" është më shumë se një veshje: është flamur, është identitet, është dashuri.

Në fjalën e tij, Presidenti Alban Xhaferi theksoi: "Këto personalitete, me penën dhe mikrofonin e tyre, kanë kontribuar që sporti, e sidomos futboli, të pasqyrohet me profesionalizëm dhe dashuri për të vërtetën. Si President i Vllaznisë ndjej krenari dhe mirënjohje për punën e tyre. Falë tyre, breza të tërë tifozësh e sportdashësish kanë ndjekur skuadrën tonë dhe sportin shqiptar me më shumë pasion."

Nënkryetarja e Bashkisë, znj. Teuta Qyteza Shala, shtoi një tjetër këndvështrim: "Nëse sportistët e kanë të kufizuar aktivitetin e tyre nga mosha, gazetarët e vazhdojnë shumë më gjatë. Ata shkruajnë, japin mendime, hapin biseda që ndihmojnë zhvillimin, që ndihmojnë të ardhmen. Roli i tyre nuk shuhet kurrë."

Në fund të ceremonisë, gazetari i njohur dhe moderator i aktivitetit, z. Bepin Kolvataj, përmbylli me fjalë të mbushura me domethënie: "Kjo iniciativë është një shenjë vlerësimi për kontributin e pazëvendësueshëm të gazetarëve sportivë në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë sportive të Shkodrës, duke i dhënë zë një qyteti që ka qenë dhe mbetet zemra e sportit shqiptar."

Emrat e nderuar të kësaj mbrëmjeje, qoftë ata që nuk jetojnë më, qoftë ata që ende frymëzojnë sot, janë tashmë pjesë e pandashme e historisë së sportit shkodran dhe shqiptar. Por mbi të gjitha, ata janë dëshmi e gjallë se dashuria për sportin, kur shoqërohet me përkushtim e integritet, kthehet në trashëgimi dhe frymëzim për breza të tërë.

Kjo ceremoni dëshmoi se gazetaria sportive nuk është vetëm profesion. Ajo është identitet, është frymë, është monument i gjallë. Është një urë që lidh të kaluarën me të tashmen dhe e çon drejt së ardhmes. Ajo vazhdon të pulsojë edhe kur stadiumet boshatisen, kur jehona e ndeshjeve shuhet, sepse pas çdo historie të madhe sportive fshihet gjithmonë një zë, një zë që nuk shuhet kurrë.

Nga RAMAZAN ÇEKA
tetor 2025

Proza e Martin Camajt



Nga GJON MARKU

Përshkruar prej një filli ku zë vend tematika prej Shqipërisë së Veriut, malësori autoritar i pathyeshëm dhe i pavarur, trim, mikpritës dhe i urtë, krenar, i flijueshëm, shpesh me jetën e tij tragjike, janë edhe novelat e Martin Camajt. E pra vargu i novelave *“Pishtarët e natës”*, *“Shkundullima”*, *“Katundi me gjuhë të fshehtë”*, *“Rrungaja në mars”*, *“Gjon Gazulli”*, që i japin dimensionin e plotë novelistikës së Camajt spikasin për natyrën e veçantë krijuese, ku bota e brendshme shpirtërore, marrëdhëniet etnokulturore dhe tradicionale, bota e tij psikologjike ndërthuren me një fill artistik, ku ndërthuren mjeshtërisht simbolika me realitetin e përsëritshëm e marrin përmasa mitike.

Po t'i referohemi krijimtarisë së Camajt në tërësi, atëherë dhjetëra poezi, e pothuajse të gjitha legjendat, apo pesë novelat, dhe veçanërisht *“Dranja”*, ndërthuren ndër bjeshkë dhe mbruhen me ritmin e saj dramatik. Ai sikur kthehet e rikthehet nëpër këto anë në Vërrin, e ecën ndër lisa, shkëmbinj, ulet në votër, në këto anë ku nuk gjenden veç zana, e ku jo vetëm lind dielli e praron hana, ku buron magjishëm lumi. Por në këto bjeshkë e ndër këto male, ku merr jetë vetëtimja e oshtin bullima, ndër këto anë, ku oshtin orteku e zbresin me rrokullima tatëpjetë e ulërin ujku, ku magjishëm jeton shqiptarja e gjarpri. Në këto bjeshkë e në këto anë, ku ndër lartësi shpesh tragjikisht e deri në kufijtë e mitikes ka ritmin e vet jeta njerëzore e bota shqiptare me pasuri të papërsëritshme gjuhësore dhe folklorike.

“Duke vepruar në këtë mënyrë autori jep imazhe e tablo artistikisht të pasura të kësaj bote, që janë të rralla në prozën tonë”, - shkruan Anton Nikë Berisha.⁽¹⁾

E gjithë proza e Camajt mund të konsiderohet një prozë realiste, e duket se ka qasje të përbashkëta me prozën e një tjetër kolosi të letërsisë shqipe, Anton Pashku, ku mënyra e ballafaqimit dhe, mbi të gjitha, e trajtimit artistik për situata të veçanta hasen rrallë në letërsinë e vendit

tonë e që rrallë jepen me kaq forcë dhe me kaq madhështi artistike, aq sa vetë proza e Camajt mund të cilësohet pa frikë prozë poetike.

Duket se prej fillimi e në fund në prozën e Camajt ngërthehen fort: përvoja me trashëgiminë dhe kujtesën. Duke e vëzhguar me kujdes prozën e Camajt, Kujtim Shala do të theksonte: “Vetë titujt shenjojnë një kapërcim nga njëra tek tjetra, pra një lidhje poetike dhe semantike, nga përvoja të trashëgimia e kujtesa. Kështu, secila pjesë jep një cikël jete dhe kujtesë”.⁽²⁾

“Pishtarët e natës”

Me një spikatje të papërsëritshme të një novelisti të talentuar e me një profil tërësisht të vetin si shkrimtar i rangut të lartë, Camaj vjen për lexuesin me një ndër novelat më përfaqësuese të tij të titulluar *“Pishtarët e natës”*.

Jo vetëm në këtë novelë, por si karakteristikë e prozës së Camajt janë përgjithësisht njerëzit kryemëvete, që jetojnë e mbrojnë traditat e tyre legjendare, që vetëqeverisen me kodet e të drejtës së një kanuni të lashtë, por që i bën këta njerëz të jetojnë me dinjitet edhe pse në një terren të ashpër, e që gjithnjë janë në konflikt me këtë vend që shpesh ka në dorë fatet e tyre.

Mjeshtërisht Martin Camaj gdhend dhe ndërton sfondin në lëvizje të bjeshkëve shqiptare ku çdo rresht, fjalë e germë merr peshë të veçantë, e në këtë sfond në lëvizje zënë vend karaktere, shpesh tragjike, të njerëzve. Edhe Nika jeton në këtë realitet tërësisht të ashpër që të afrojnë malet shqiptare. Në këtë realitet me ujë e ortek, me korb e me gjarpër, me mite dhe legjenda. Prej maleve zbret tragjikisht jeta njerëzore, e ky realitet ngërthen me histori tragjike edhe jetën e tij. Camaj me aftësinë e vet si një mjeshtër i fjalës, me një origjinalitet artistik të spikatur, të papërsëritshëm dhe me pasuri të rralla stilistikore, krijon dhe ndërton një personazh përgjithësues mjaft domethënës e nga më të spikaturit në letërsinë tonë.

Nika te *“Pishtarët e natës”*, zot i bjeshkës, që udhëtarët e huaj që banonin te ai mendonin se “patën kthye në botën e zotave e të njerëzve homerikë, qëndron-te përmbys në tokën e çelur prej tij, me grushtet e ngrimë e me gojë shtrëngonte dhe...”, shkruan Koçi Petriti, në gazetën Drita.⁽³⁾

E ky “Zot i bjeshkëve” jeton jetën e tij që është e mbushur me histori tragjike, edhe pse në këtë novelë monumentalizohet ëndrra e malësorit për tokë, që barazohet me qëllimin për jetën. Jetën në male, që ai e bën në një izolim pothuajse të plotë, mundohet ta ndërtojë dhe ndryshojë rreth vetes e të krijojë një vatër amatore imagjinare e disi përrallore.

Bota e Nikës është e lidhur pazgjidhshmërisht me botën e malit, ai kërkon ta transformojë i vetëm atë në të mirë të tij dhe të fëmijëve të tij, për të zgjidhjet e tjera nuk i përkasin atij. Jeta e Nikës është shumë e vrazhdë, si vetë terreni ku ai jeton.

Është natyra dhe kushtet e terrenit të

ashpër dhe konfiguracioni gjeografik, që ndikojnë në psikologjinë dhe botëkuptimin e tij individual. Camaj hy thellë në psikologjinë e malësorit që e mishëron te Nika. Ai pa diskutim është një njohës perfekt i kësaj psikologjie dhe i këtij mendimi. Jeta e tij është vërtet e çuditshme dhe bëhet një figurë mitike.

“Vetmia e plakut Nikë, që veçohet edhe prej familjes së vet për të arritur deri në prag të vdekjes, që t’ua shtojë tokën në trashëgim fëmijëve, shpreh sa karakterin individualist të malësorit shqiptar, aq edhe qortimin e tërthortë të entuziazmit kolektivist-kooperativist të kohës,” -shkruan Shaban Sinani.⁽⁴⁾

Nika është modeli dhe mishërimi i malësorit që shkon në sakrifikim e flijim për tokën, pronën. Vetë ai e ka të lidhur pazgjidhshmërisht jetën me tokën. Ai i humbet lidhjet njerëzore me njerëzit e tij të gjakut, aq sa nuk di as emrat e nipërve e mbesave, ai s’i kishte ngjitur shkallët e kullës së të vëllait që prej njëzet vjetësh kur ishin ndarë, ndërsa njehet me natyrën që i merr jetën.

Personazhi i Nikës të *“Pishtarët e natës”* gdhendet mjeshtërisht prej autorit, duke na dhënë me një peshë të madhe e me një ngarkesë të fortë emocionale një personazh të papërsëritshëm, pikërisht pse Camaj veç psikologjisë së malësorit që e njeh mirë dhe hy thellë në të, ai këtë personazh e vë në një realitet natyror që për të jo vetëm nuk është i panjohur, por njihet mirë.

Autori mjeshtërisht e me një intuitë të papërsëritshme krijuese arrin të mbajë me një intensitet të lartë artistik novelën e tij, me zhdërvjelltësi dhe me një imagjinatë të jashtëzakonshme gdhend personazhin e Nikës.

Në përballjen e vazhdueshme me natyrën Nika bëhet viktimë e saj. Është modeli i individit që shkon gjer në sakrifikim e flijim për tokën, pronën, çka shënjon edhe anën tragjike të këtij karakteri, të këtij karakteri që arrin të ndryshojë dhe dyfishojë pronën që do t’i lerë në trashëgim Nikës, që lind në ditëvdekjen e tij. E në mënyrë mitike lajmërohet vdekja e Nikës, siç në mënyrë legjendare lajmërohet lindja e Nikës së ri.

Të duket se je në një botë mitesh dhe legjendash kur mendon *“Pishtarët e natës”* që nisen nga vërrini, nga bjeshka a fundina. Ngritur në një nivel artistik tepër emocionues ai jep dhe solidaritetin e këtyre njerëzve për t’iu gjendur njëri-tjetrit në ditën e vështirë. Ashpërsia nuk i ndalon ato të solidarizohen me njëri-tjetrin dhe të ndërtojnë mitin e mbijetesës.

“Mbijetesa e njeriut mbi gurin e moçëm, në zgafella të humbura të natyrës alpine shqiptare, atje ku bishat dhe egërsirat janë të pranishme si gjallesat e shtëpisë, përbën thelbin e shumicës së veprave të tij”, -shkruan Shaban Sinani.⁽⁵⁾

Personazhet e Camajt janë tipike shqiptare në gjithçka: në veshje, mendim, mënyrën e jetesës, psikologjinë e tyre pa diskutim në ambientin shoqëror, besëtytnitë, mitet e mitologjitë, dukuritë,

mitologjike, legjendat, e të tjera, që ndikojnë në formimin e karakterit të malësorit.

Nuk është e rastit, që disa prej veprave të Camajt e marrin titullin pikërisht prej fatkeqësive natyrore, si *“Pishtarët e natës”*, *“Shkundullima”* e *“Rrungaja në mars”*.

“Shkundullima”

“Ndarja e hershme e Martin Camajt me vendlindjen dhe atdheun dhe gjallimi larg tyre për gati gjysmë shekulli u shndërruan në një ndjenjë dhimbjeje, që u ushqye dhe u mbajt gjallë vijueshëm nga vetmia, e cila po ashtu iu bë pjesë e pandashme e qenies së tij dhe e bëri atë shpesh të vuante”, shkruan Vojislav Dancetoviq.⁽⁶⁾

Duket se frika për hmbjen e përherëshme të atdheut dhe vendlindjes e bëjnë Camajn të rendë drejt bashkatdhetarëve. Ai e ka të pamundur të shkelë në tokat shqiptare, kështu që ai e kërkon këtë atdhe dhe vendlindje të humbur në një katund arbëresh që në fakt është gjysmë i braktisur. Dashuria midis Ntonies dhe Vitos është e përkohshme. Ëndrra që ka Vitoi mbetet e paralizuar.

Është *“Shkundullima”* (termeti) që shkatërron gjithçka mbi dhe. Ky katund që përshkruan Camaj është gjysmë i braktisur, një fshat i prapambetur që nuk e pranon qytetërimin e që në fund shkallmohet pamëshirshëm prej termetit. Camaj sikur ndjek fatëkeqesitë e këtij populli, në fakt njerëzit e të të njëjtit gjak, ai i do njerëzit me të arrirë e më të mirë në botë. Shkundullima vjen nga deti e bije në sy ardhja fluturimth e Vitoit për t’u vënë në shërbim të njerëzve në atë moment të vështirë dhe fatal. Me një përshkrim të mahnitshëm Camaj pasqyron brigjet bregdetare të Italisë së Jugut, treva ku prej shekujsh jetojnë arbëreshët.

Tek *“Shkundullima”* që përfshin katundin arbëresh, termeti nuk është si te orteku në *“Rrungaja në mars”*, që rrëzon dashurinë e dy të rinjve, Jerës dhe Dakut, por është jashtëzakonisht tronditëse, pasi shkatërron një vend dhe një komunitet nga rrënjët dhe themelet.

Duke bërë fjalë për këtë novelë, A. Klosi shprehet se “...është një fikson i sforcuar ku personazhet ndihen si të prerë me gërshërë në tryezën e punës dhe jo të prekur me jetë”.⁽⁷⁾

“Shkundullima” është botuar në vitin 1981, e cila është bërë pjesë e veprës së plotë të Camajt dhe botohet në vëllimin e katërt me një parathënie të studiuesit Ardian Klosi. Nuk është ky sinializimi dhe trajtimi i parë i Camajt si novelist qysh herët ai ishte trajtuar prej Koliqit e Pipës, që kanë analizuar veprën e Camajt, duke i kushtuar artikuj, parathënie e gjer monografi, ku theksohet fort Camaj si novelist i rangut të lartë dhe si një prurje e veçantë në letërsinë shqipe. E po në fillimet e viteve 80 me Camajn merret edhe studiuesi i mirënjohur Anton Nikë Berisha.

Camaj ka shkruar gjithnjë në mënyrë të koncentruar duke i dhënë peshë çdo fjalë dhe germe.

Novelat *“Shkundullima”*, *“Pishtarët e*

natës” apo “Rrungaja në mars” mund të konsiderohen si vepra realiste. E në të tria këto raste Camaj e kërkon fatalitetin tek natyra.

Tek “Shkundullima” Camaj vë përballë dhe qytetërimin dhe mospranimin e tij.

“Rrungaja në mars”,

Mali ishte ai që ua preu në mes dashurinë e dy të rinjve. Dakut ia merr jetën një ortek. E Camaj mjeshterisht shkruan: “Djalit nuk i doli kohë me ndigjue as shungullimën, as dridhjen e maleve: gjithçka, bashkë me Dakun treti nën tokë! Shembja e borës me dhe e lisa në faqen e malit zgjoi njerz e shtazë prej jermit dimnor në Përtejfaqën: kushtrim i tmerrshëm! Mbas shtangimit të parë, pleqtë u betuen me gjithçka u erdh në gojë, për tokë e qiell! Banë be tue nemë edhe veten: “rrufëja në gjoftë!, - thanë, - në paçim ndëgjue tash shtatë brez se një rrungajë si kjo është shkoq kurr këtij dheu!”. (8)

Jera dhe Daku janë dy personazhe të skalitura me kujdes dhe vendosur në pothuajse të njëjtin mjedis si ai i novelës “Pishtarët e natës”, ku gjithashtu kemi bjeshkë dhe vërri po nëse ambienti duket i përafërt dashuria e Jerinës dhe Dakut është një dashuri e ndërprerë si ajo e Ntonies dhe Vitoit tek “Shkundullima.”

Autorit ndjen mall për viset e veriut, pa qenë asnjëherë rob i saj, ai kërkon ruajtjen e gjithçkaje që është e vyer por futjen e frymës së qytetërimin e sheh si të domosdoshme.

“Një dëborë e parakohshme dhe një ortek i papritur (rrungajë), bëjnë që Daku jo vetëm të mos mundet të ndryshojë gjë, por të humbë dhe jetën prej trilleve të natyrës së ashpër”. (9)

Nëse për Dakun ky është fundi fatal dhe vdekjeprurës për Jerën, mali është dhimbje dhe fat i paracaktuar.

Daku, një student që, sapo është kthyer me pushime në vendlindje, bashkë, me Jerën i kalon pushimet në përpjekje për të zbuluar të fshehtat natyrore dhe begatinë shpirtërore të krahinës. “Ata veprojnë e gjallërojnë midis dëshirave e pamundësive, ballafaquar nga vështirësitë e jetës dhe nga marrëdhëniet patriarkale, që në shumë pika përcaktojnë fatin e individit”. (10)

Jera dhe Daku janë të lidhur në një dashuri normale, që nuk ka arsye apo ndonjë shkak pengues, si bie fjala paragjykimet apo forca e kanunit, por është një fatkeqësi natyrore (orteku – rrungaja) që e ndërpret këtë lidhje. Autori këtu përdor me mjeshtri, një fatkeqësi natyrore, që vjen si zgjidhje e menjëherëshme (e pa prituri, e përnjëhershme) të përdorura nga teatri dhe tragjeditë e lashta greke. Përmes kësaj zgjidhje, këtij orteku, në zemër të pranverës, - stinës (simbolike të jetës), e ringjalljes së gjithçkaje, a Dakut e fatalitetin e Jerës, pikërisht në këtë stinë të konceptuar (sipas asaj që përjeton Martin Camaj) si simbolikë e vdekjes fizike të dashurisë pasionit. Pasioni i fortë i dashurisë te Jera bën që ajo të kthehet në një figurë të heshtur, mplaket e vdes me kujtesën e pashuar të asaj dashurie.

Dashuria që fillon në mal është paracaktuar të shuhet. Mali ka kodet e veta, e njerëzit e malit duhet t’u nënshtrohen këtyre kodeve, e kur këto kode shkelen mali hakmerret deri në vdekje nën ortek. Nuk janë kodet njerëzore që pengojnë dashuri-

në e Dakut dhe Jerës, por ligjet e natyrës. E nëse Daku vdes nga rrungaja, Jera shkatërrohet ngadalë-ngadalë duke i qëndruar besnike dhimbjes dhe pikellimit shpirtëror për Dakun.

“Rrungaja në mars” të sjell ndërmend krijimet e Koliqit e të Migjenit.

Në “Rrungaja në mars” apo tek “Shkundullima” Camaj ka një situatë dominimi të enigmës, ndërthurur me situata mjaft të ndërlikuara e me një gjuhë mjaft të koncentruar.

“Katundi me gjuhë të fshehtë”

“Katundi me gjuhë të fshehtë” është një prozë moderne me elementë artistikë të përdorur me një racionalitet të papërsëritshëm e të shkëlqyer. Një novelë vërtet befasuese e me një mënyrë origjinale të të shtjelluarit dhe të ndërthurjes, përsa i përket elementëve artistikë. Katundi i çuditshëm me gjuhë të fshehtë që e flasin këta njerëz vjen nëpërmjet një të HUAJI që vjen nga VERIU drejt JUGUT dhe e vetmja lidhje është gjuha. Ai shkon çdo sezon plazhi atje si i huaj dhe gjithnjë brenda tij gjallon dëshira për t’u ngjitur nalt, atje ku është katundi me gjuhë të fshehtë, që mund të jetë dhe një varrezë.

Ai është i huaj, pikërisht atje ku nuk mund të jetë i tillë, te njerëzit që flasin si ai. Në katund është Flora që takohet me burrin e huaj në farmacinë e dikurshme të xhaxhait. Por, si dhe te novelat e tjera, dhe këtu kemi një dashuri të parealizuar, por që nuk ka qenë pengesë “rrungaja,” apo “shkundullima,” po vetë njeriu, madje vetë ai që kujtimet e kthejnë dhe e rikthejnë tek ajo dashuri.

Ky i huaj, që pritet çdo shtator prej banorëve dhe përcillet prej tyre, nuk është gjë tjetër veçse një gjurmues forklori që merret mes të tjerash me studimin e formulave të magjive, e për këtë i ngjesin dhe mbiemrin shtrigan.

“Ju keni kalue atje një mbasdite në shoqinë e mordjes. Para një vjeti a dhjetë vjetësh s’ka randësi.” (11)

Martin Camaj nëpër rrugën e gjatë dhe të vështirë në të gjithë veprimtarinë e tij letrare ka pasur lidhje të ngushta me folklorin. Zona e Dukagjinit është e njohur si konservatore, me një shoqëri patriarkale deri në fillimin e shek. XX.

Kjo zonë shfaqet si një rezervat i së drejtës zakonore përmes një mundësie arkaike, zonë që pati shërbyer sidomos te shkrimtarët e veritit si një arsenal mitesh, rithes të epokave të lashta, si një depozitë legjendash me njerëz që janë mjeshtër të formulimit sintaksor. E për rastin e Camajt është e njohur prirja e fortë e tij për të gjurmuar traditën dhe visaret e autoktonisë së etnokulturës. Duke e njohur mirë botën shqiptare me të gjitha shpalimet e veta hulumtimi dhe studimi i literaturës i mundësoi atij një njohje të thellë edhe në planin gjuhësor, çka i shërbeu më së shumti në ngjizjen e veprave të ardhshme letrare. Ai e ngre lart këtë botë mitesh dhe legjendash në krijmtarinë e vet dhe e modernizon paraqitjen e tyre për lexuesin.

Camaj e sjell dhe e risjell botën ku ka kaluar fëmijërinë edhe pas një mungese dhejetëra vjeçare por me një këndvështrim tjetër. Me vetëdije ai përdor e ripërdor shprehje të jetës së malësore.

I huaji dhe Flora nuk mund të përfytyrohen jashtë ambientit natyror ku i ven-

dos Camaj.

“Gjon Gazulli”.

Martin Camaj është persoonliteti i letrave shqipe që gjithnjë e ka të fortë prirjen për të gjurmuar traditën shqiptare e sidomos për të njohur mirë traditën e shkruar. Gjon Buzuku është dhe tema e tij e doktoraturës në universitetein “La Sapienza”. Por ai e njihte mirë dhe trashigëminë tjetër kulturore dhe shkrimore të parardhësve të vet. Natyrisht ai ndalet dhe të humanisti dhe personaliteti i shquar i Rilindjes Europiane, profesori i universitetit të Padovës Gjon Gazulli. Camaj ndërton artistikisht figurën e këtij humanisti, natyrisht në vendin tonë kishte një njohje fluide për të, por krejt ndryshe duket që ndodh me Camajn i cili patjetër kishte një informacion të plotë rreth kësaj figure të madhe.

Me novelën “Gjon Gazulli”, Camaj vjen krenar dhe për plejadat e dijetarëve shqiptarë ndër shekuj. Për ato plejada të ndritura që kishin zënë vend me dinjitet në Europën e qytetëruar. Natyrisht shumë prej tyre nuk i gjenin kushtet e përshtatshme për të kuontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendit të tyre prandaj ishin larguar e, si dhe Camaj, ishin në një farë mënyre me atdhe të humbur.

Edhe Gazullin shumë shekuj më parë, ashtu si dhe Camajn, në mënyrë të herëpashershme e thërret zëri i vendlindjes.

Camaj mbeti përjetë malësor. E qenia e pandashme “malësor” është përherë në qenien e tij. Dhe ai shkruan vashdimisht për jetën malësore që i ka lënë mbresë.

“Dranja”

Dranja: Vepra e Camajt u krijua në vazhdimësi në një periudhë mbi dyzetvjeçare në kushte e rrethana të veçanta, por gjithnjë përshkruhet nga një ndjenjë dhimbjeje. E nëse flasim për dhimbjen, atëherë dhembjen më të kulluar e gjejmë tek “Dranja,” ku në një vepër të vetme ndërthehen një varg rrëfimesh të cilat nuk kanë lidhje të kushtëzuara me njëra -tjetrën.

Studiuesi Koçi Petriti, duke gjykuar mbi poetikën e Camajt, nënvizon: “Poetika e udhës, e shtegtit, e sfidimit të izolimit është pothuajse zotëruese jo vetëm te Dranja e në poezinë e këtij autori, por edhe në prozën e tij, te “Pishtarët e natës”, te “Rrungaja në mars”, te “Gjon Gazulli”, te “Shkundullima”. (12)

“Vetë titujt shënojnë një kapërcim nga njëra tërësi te tjetra, pra një lidhje poetike e semantike, nga përvoja te trashëgimia e kujtesa. Kështu, secila pjesë jep një cikël jete e kujtese”, pohon Kujtim Shala. (13)

Dranja nis me rrëfimin e natyrës, me kushtet e terrenit të ashpër, mjedisin malor të virgjër, të ngjallur përmes kujtesës mitike e mistike të vendit, me ndikim në psikologjinë, botëkuptimin e individit. Vetë rrëfimi është më së shumti simbolikë e parë në këtë këndvështrim, një histori e tillë e vendosur tek një frymor i papërsosur ku përshkruhet me nota të thella dhimbjeje.

“Dhimbja bën që kritika të mos thuhet edhe kur shkruhet, që Camaj të mbetet i paangazhuar. Ai do që lexuesi t’u japë jetë ideve, kur e ka këtë fuqi, ose

të provojë pafuqinë e tij në lëme të lehta idologjike”. (14)

“Tek Dranja, Camaj flet për fatin e jetës së vet, origjinën e tij fisnore, udhëtimet dhe vendosjen e tij jashtë atdheut, që janë momente shumë të rëndësishme në jetën e tij”. (15)

Vepra e Camajt në tërësi është e mbushur me orë e zana, më shtojzavalle, por dhe me dukuri dhe fenomene shkatërruese, si: murlani, tërmeti dhe orteku me ndikime serioze në psikologjinë e malësorit. Kjo e bën veprën e Camajt thellësisht shqiptare të vendosur në një ambient etnik dhe personazhet e Camajt janë të papërsëritshëm pse janë të tillë, fisnikë.

Por nga ana tjetër kemi një gjuhë të zgjedhur. A. Bersisha shkruan: “Nëpërmjet strukturës gjuhësore artistike dëshmohe se e vërteta poetike ekziston dhe funksionon në të njëjtën kohë në disa rrafsh, në ndërlidhje shumëplanëshe, e jo si e vërteta shkencore, e cila ekzistencën e vet e dëshmon në një rrafsh. Pikërisht për këtë arsye, në këto proza e vërteta artistike gjakohet parreshtur; ajo është dhe ideal i Camajt.” (16)

Studiuesi Koçi Petriti nënvizon: Poetika e udhës, e shtegtit, e sfidimit të izolimit është pothuajse zotëruese jo vetëm te Dranja e në poezinë e këtij autori, por edhe në prozën e tij, tek Pistharët e natës, te Rrungaja në mars, te Gjon Gazulli, te Shkundullima. (17)

Ndër vlerat më të spikatura në veprën e Camajt është gjuha e përdorur e cila është një gegnishte letrare që Camaj e ka përdorur mjeshtërish, të cilën e ka mjaft të pasur dhe shpesh dhe të ndërlikuar dhe me fjalëformime të shumta duke pasuruar më tej gjuhën letrare kombëtare .

Literatura

Berisha, Anton: “Vepra letrare e Martin Camajt”, Princi, Tiranë, 2010, f.122.

Shala, Kujtim: “Camaj i pa (zbuluem)”, “Prolepsa” AIKD, Prishtinë, 2011, f. 54.

Petriti, Koçi: “Në poetikën e Martin Camajt: miti i gjarpërit, metafora e hijes, kulti i lisit”, “Drita, Tiranë, 1997.f.64.

Sinani, Shaban: “Camaj i paskajtur”, botimet “Naimi”, Tiranë, 2011.f .36.

Sinani, Shaban: “ Camaj i paskajtur”, botimet Naimi , Tiranë, 2011, f. 256.

Dancetoviq, Vojislav: “ Ku qëndron origjinaliteti i Camajt?”, “Jeta e re,” Prishtinë, 1996, f.74.

Klosi, Ardian: Martin Camaj, Vepra Letrare I, Tiranë, 1996, parathënia, f. 39 - 40.

Camaj, Martin: “Rrungaja në Mars”, botimet Camaj -Pipa, Shkodër, 2008, f 74.

Sinani, Shaban: “Camaj i paskajtur”, botimet Naimi, Tiranë, 2011, f. 256.

Berisha, Anton Nikë: “Vepra letrare e Martin Camajt”. Tiranë, 2000, f.124.

Camaj, Martin: “Katundi me gjuhë të fshehtë”, po aty, f. 254.

Koçi, Petriti: Në poetikën e Martin Camajt, Tiranë, 1997,f. 116.

Shala, Kujtim: “ Camaj i pa (zbuluem)”, në: “Prolepsa” AIKD, Prishtinë, 2011, f 54.

Shala, Kujtim: “ Camaj i pa (zbuluem)”, në: “Prolepsa” AIKD, Prishtinë, 2011, f 55.

Pipa, Arshi. “Poezia dhe poetika e Camajt “ në: “Jeta e re” , Prishtinë, 1996, f.16.

Berisha, Anton: Vepra letrare e Martin Camajt, f. 114.

“Projekti Shpresa” festoi 30-vjetorin e themelimit – Tri dekada përkushtim, dashuri dhe shpresë

Më datë 24 tetor 2025 në një atmosferë plot emocion e reflektim, Shoqata “Projekti Shpresa” kremtoi 30-vjetorin e themelimit të saj në ambientet e **Hotel Colosseo** në Shkodër. Aktiviteti, që u zhvillua nga ora 10:00 deri në 13:00, mbledhi bashkë partnerë institucionalë, përfaqësues të organizatave vendase e të huaja, miq e bashkëpunëtorë shumëvjeçarë të shoqatës, si dhe anëtarë të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara.

Ceremonia u drejtua nga **Dokt. Suela Ndoja**, e cila hapi aktivitetin me një përshëndetje të ngrohtë për të pranishmit dhe një minutë heshtje në nderim të **Dr. Silvana Vignali**, themeluese e “Projektit Shpresa”, si dhe të disa anëtarëve të ndjerë të komunitetit që kishin lënë gjurmë të pashlyeshme në rrugëtimin e shoqatës.

Në fjalën e tij përshëndetëse, **z. Lugi Mila**, president i Shoqatës “Projekti Shpresa”, kujtoi me mirënjohje fillimet e vështira të viteve ’94 për rrugëtimin e gjatë të themelueses dhe përkushtimin e vazhdueshëm ndaj personave me aftësi të kufizuara. Ai falënderoi të gjithë ata që e kishin mbështetur misionin e shoqatës ndër vite, duke theksuar se “Projekti Shpresa” mbetet një dritë që ndriçon përmes dashurisë, kujdesit dhe solidaritetit njerëzor.

Në vijim të aktivitetit, përshëndetjet e tyre i sollën personalitete të rëndësishme të jetës fetare, politike e akademike të qytetit.

Mons. Giovanni Peragine, Arqipeshkëv i Arqidioqezës Metropolitane Shkodër-Pult, vlerësoi rolin e “Projektit Shpresa” si një shembull konkret i dashurisë në veprim dhe i përkushtimit të krishterë ndaj njeriut në nevojë dhe bëri thirrje për vijueshmërinë e mbështetjes nga organet kompetente dhe nga komuniteti e më gjerë.

Znj. Marjana Koceku, deputete e qarkut Shkodër, dhe **Znj. Teuta Qyteza**, nënkryetare e Bashkisë Shkodër, shprehën mirënjohjen e tyre për punën e palodhur të shoqatës në integrimin dhe fuqizimin e personave me aftësi ndryshe.

Një fjalë përzemërsi mbajti edhe **Mons. Angelo Massafra**, bashkëkryetar i “Projektit Shpresa”, i cili kujtoi me emocion ditët e para të bashkëpunimit dhe frymën e dashurisë që kishte udhëhequr këtë nismë që nga themelimi.

Në emër të institucioneve shtetërore, foli **Znj. Reme Lala**, Drejtore e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, e cila vlerësoi “Projektin Shpresa” si një model bashkëpunimi për zhvillimin e politikave sociale dhe ofrimin e shërbimeve cilësore në komunitet.

Po ashtu, **Z. Edmond Ndou**, Kryetar i Këshillit të Qarkut Shkodër, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe e cilësoi “Projektin Shpresa” si një pasuri për gjithë rajonin.

Moment i veçantë i programit ishte **shfaqja e dokumentarit “30 Vjet Shpresë, Përkujdesje dhe Integrim”**, i cili solli përmes imazheve dhe dëshmimeve një udhëtim prekës në historinë e shoqatës, që nga themelimi i saj e deri në ditët e sotme.

Pas shfaqjes së dokumentarit, u zhvillua **ceremonia e nderimeve dhe mirënjohjeve**, ku u shpërndanë certifikata vlerësimi për institucione, organizata dhe individë që kishin dhënë një kontribut të çmuar në mbështetje të misionit të shoqatës.

U nderuan ndër të tjera: **Bashkia Shkodër, Drejtorja Rajonale e Punësim-it, Spitali Rajonal Shkodër, Caritas Dioqezan Shkodër, Administrata e Zonave të Mbrojtura**, si dhe organizata ndërkombëtare si **Alpini di Lugagnano (Verona)** dhe **Entreculturas (Spanjë)**. Gjithashtu u vlerësuan edhe bashkëpunëtorë e vullnetarë të huaj e vendas, për kontributin e tyre afatgjatë në projektet e shoqatës.

Në këtë ceremoni, **Z. Edmond Ndou** nderoi pas vdekjes themeluesen (**Dr. Silvana Vignali**), si dhe dorëzoi certifikata mirënjohjeje për vetë Shoqatën “Projekti Shpresa” dhe organizatën italiane **“Comitato della Lotta contra la Fame nel Mondo”**, duke i cilësuar si faktorë të rëndësishëm të ndryshimit social dhe solidaritetit ndërkombëtar.

Në pjesën e fundit të aktivitetit, **z. Lugi Mila** prezantoi vizionin e së ardhmes së shoqatës, duke theksuar se “Projekti Shpresa” do të vazhdojë të zgjerojë fushat

e ndërhyrjes dhe bashkëpunimit, për të garantuar përfshirje të plotë dhe dinjitet për çdo njeri në plane afat-shkurtra (dy vjeçare) dhe afat gjata (5 vjeçare).

Ngjarja u pasurua me **momente muzikore** nga Prof. **Bepin Vjerdha** dhe Prof. **Anton Kaftalli**, që sollën një atmosferë festive e reflektuese.

Në mbyllje, të ftuarit ndanë mendime e kujtime në një **diskutim të hapur me njëri tjetrin**, të shoqëruar me pushimin e kafesë, ndërsa pasdite u zhvillua një **vizitë në ambientet e shoqatës**, për të parë nga afër punën e përditshme të saj.

Dita u përmbyll me **Meshën e Shenjtë** në Kishën “Zoja Rruzare” në Arrë të Madhe, si një moment falënderimi dhe reflektimi shpirtëror.

Në fund të këtij jubileu, mbeti i qartë një mesazh i vetëm: **“Shpresa nuk është thjesht pritje për një mrekulli, por besim se çdo gjest i vogël mund të ndryshojë botën.”**

Përgatitur nga:

NDUE SANAJ & Redaksia e Gazetës “Dukagjini”



Të jesh mësues, një sfidë mes detyrës dhe misionit

Ndoshta nuk ka fjalë të mjaftueshme që mund të përshkruajnë plotësisht rolin e mësuesit, në një botë ku gjithçka ndryshon me ritme marramendëse dhe ku shpesh, vlerat thelbësore harrohen. Por një gjë është e sigurt që të jesh mësues në ditët e sotme nuk është thjesht një profesion, por është një sfidë, një thirrje, një mision.

Çdo mëngjes e nisin ditën me libra në dorë dhe me shpresën në zemër, duke hyrë në një klasë ku përballen me më shumë se thjesht nxënës: përballen me shpresa, me dyshime, me ëndrra dhe me plagë që ndonjëherë nuk duken. Nuk japin vetëm mësim nga tekstet shkollore por formojnë karaktere, udhëheqin shpirtin të rinj dhe, në mënyrën më të heshtur, mbjellin vlera që do të lulëzojnë për vite me radhë.

Nuk është gjithmonë e lehtë. Mungesa e vlerësimit, sfidat sociale, teknologjia që shpërqendron, mungesa e mbështetjes... të gjitha këto e bëjnë detyrën e mësuesit të rëndë. Por ajo që bëjnë ka peshë më të madhe se çdo vështirësi, ndërtojnë të ardhmen. E bëjnë këtë jo vetëm me dije, por me dashuri, me durim, me përkushtim dhe pikërisht këto e kthejnë detyrën në një mision të shenjtë.

Mbase shpesh ndihen të lodhur, të pavlerësuar, të tejngopur me presione e përgjegjësi. Por, ndoshta, diku në një bankë shkolle, ndodhet një nxënës që do ti kujtojë gjithë jetën, për një fjalë inkurajimi, për një buzëqeshje kur kishte nevojë, për një dorë të zgjatur kur ishte gati të dorëzohej.

Misioni nuk matet me nota apo statistika. Matet me zemrat që preken, me ëndrrat që nuk shuhën, me rrugët që ndriçohen nga fjala e tyre. Ata janë udhërrëfyes të heshtur të shumë udhëtarëve të vegjël, që një ditë do të ecin të sigurt, falë dritës që dhanë pa kërkuar asgjë në këmbim.

Të jesh mësues ka qenë gjithmonë një nga profesionet më të respektuara dhe më të rëndësishme në shoqëri. Por sot, më shumë se kurrë, të jesh mësues është bërë një sfidë e vërtetë, ku balancohet detyra profesionale me misionin njerëzor për të ndërtuar të ardhmen. Në një botë që ndryshon me ritme të shpejta, me teknologji që zhvillohet çdo ditë dhe me një shoqëri gjithnjë e më kërkuese, roli i mësuesit është shumë më kompleks se më parë.

Detyra e një mësuesi nuk është më thjesht të japë dije, por të jetë edhe mentor, edukator, psikolog, dhe ndonjëherë edhe prind i dytë për nxënësit. Ai përballët çdo ditë me vështirësi të ndryshme, nga mungesa e mjeteve didaktike, tek lodhja fizike dhe emocionale, tek presioni i rezultateve dhe vlerësimeve, dhe deri tek mungesa e vlerësimit të duhur nga shoqëria. Megjithatë, shumë mësues vazhdojnë punën e tyre me përkushtim të plotë, sepse e shohin profesionin e tyre si një mision jetësor.

Misioni i mësuesit është më i thellë se një detyrë që përfundon në fund të orarit mësimor. Ai është misioni për të ndi-

kuar në formimin e brezave të rinj, për të mbjellë vlera, për të frymëzuar mendje dhe për të zgjuar dëshirën për dije. Mësuesi ka fuqinë të ndryshojë jetë. Një fjalë e mirë, një inkurajim në momentin e duhur, mund të ndryshojë rrugën e një nxënësi për mirë.

Të jesh mësues sot kërkon guxim, pasion dhe një ndjenjë të lartë përgjegjësie. Është një profesion ku lodhja fizike shpesh është më e vogël se sfidat emocionale. Por pavarësisht vështirësive, për shumë mësues, buzëqeshja e një nxënësi që mëson diçka të re apo përparon në jetë është shpërblimi më i madh.

Mësuesit meritojnë falënderim për përkushtimin, për përballimin, për durimin, dhe mbi të gjitha, për dashurinë me të cilën e kryejnë këtë mision. Sepse pikërisht kjo dashuri është ajo që mbjell shpresë për të ardhmen.

Meritojnë falënderim të gjithë ata mësues që zgjedhin çdo ditë të mos dorëzojnë, që qëndrojnë në klasë me pasion edhe kur ndihen të padukshëm. Mbase nuk thuhet shpesh, por puna e tyre është thellësisht e vlefshme. Janë ata që ndërtojnë themelet e së ardhmes, një fjalë të mirë, një mësim të dhënë me zemër, një buzëqeshje të dhuruar në ditën e duhur. Bota ka nevojë për më shumë njerëz të tillë!

Në përfundim, të jesh mësues në ditët e sotme është një sfidë mes detyrës dhe misionit, por një sfidë që kur pranohet me zemër, ka fuqinë të ndryshojë botën: një nxënës, një klasë, një brez njëherësh.

MËSUESI, ARKITEKTI I SË NESËRMES

Në bankat e heshtura nxënësit rrinë, me sy që kërkojnë një ndriçim nga larg, aty vjen mësuesi, me zemër plot dritë, me fjalën që mbjell një fillim të bardhë.

Sëshhtë veç mësues, por shpirt i qartë, një udhërrëfyes në stuhitë e jetës, që mëson me zemër, me dorë të artë, pa u lodhur, pa prituri të mbledhë shpërblimet.

Një qiri që digjet e të tjerët ndriçon, një tokë që e mbjell pa zë e pa trumbeta, një sy që përtej notës e librave shikon, një zë që zgjon ëndrrat nga heshtja. Formon mendjen dhe shpirtin e dliër bën nxënësin të besojë që triumfon, se brenda tij fshihet e madhja fuqi, që pret të zgjohet nga dora që kupton.

Me fjalët e kujdesshme farë jete mbjell, në shpirtin e një brezi që do të vijë, çdo vështrim i tij, një dritare plot diell, drejt një bote më të mirë, më të ndritshme, më të lirë.

Në një botë ku gjithçka tretet e ndryshon, mësuesi si gur në themele mbetet, sepse me dashuri e durim ndërton, atë që s'mund ta shembin as shekujt, as tërmetet.

Prandaj le ta duam, ta çmojmë me shpirt, se pa të, s'ka nesër, s'ka dritë, s'ka jetë. Mësuesi është shpresa, fjala, rruga që ndrit, shoqërinë drejt dritës e çon në çdo hap, përjetë.

Nëse shoqëria është një kopsht i madh me bimë të ndryshme, atëherë mësuesi është kopshtari i palodhur që me durim, përkushtim dhe dashuri kujdeset për çdo filiz të ri që rritet në këtë tokë. Nuk mbjell vetëm dije, por mbi të gjitha mbjell frymëzim, moral dhe ndjenjë përgjegjësie për të nesërmen. Është zëri i parë që e bën fëmijën të besojë se ka vlerë, syri që sheh përtej mungesës dhe gabimeve, dora që udhëheq drejt horizontit të pafund të dijes.

Mësuesi është themeli mbi të cilin ngrihet çdo brez. Nuk ndërton ura betoni apo rrugë asfaltike, por ndërton ura mendimi, krijon rrugë shpirtërore dhe ndriçon udhët që shpesh janë të mjegullta për një mendje të re. Mësuesi flet për botën jo vetëm me fjalë, por me shembull, me pasion dhe me zemrën e tij të madhe. Ai është si qiriri që digjet për të ndriçuar të tjerët, pa u ankuar kurrë për dritën që po humbet nga vetja.

Ndikimi i tij nuk matet me statistika, por me jetë të ndryshuara. Një fjalë inkurajuese nga një mësues në klasë mund të bëhet shtysë për një nxënës që sot heziton të flasë, e nesër të bëhet lideri i së ardhmes. Një vështrim i ngrohtë mund të shuajë ankthin e pasigurisë, dhe të ndezë guximin për të ecur përpara. Mësuesit nuk shpikin heronj, por i zbulojnë ata në heshtje dhe i rrisin me dashuri.

Shoqëria që nderon dhe vlerëson më-



suesin është një shoqëri që investon në të ardhmen e vet. Sepse çdo mësues i mirë është një arkitekt i së nesërme. Ai nuk jep thjesht mësim, por formon karaktere, krijon qytetarë të ndërgjegjshëm, të ndershëm dhe të aftë për të ndryshuar botën.

Në kohëra të turbullta është busulla morale dhe në kohëra të qeta është shtytja drejt përmirësimit. Nuk ka profesion më fisnik se ai që formon njerëz, që kultivon mendjen dhe ndriçon shpirtin. Një shoqëri që investon në arsim është një shoqëri që beson në zhvillim dhe mësuesi qëndron gjithmonë në zemër të këtij zhvillimi.

Mësuesi është si një poezi që nuk lexohet vetëm me sy, por ndihet me zemër. Roli i tij është i pamatshëm dhe ndikimi i tij është i përjetshëm. Shoqëria e ardhshme është pasqyra e mësuesve të sotëm. Dhe sa më shumë të ndriçojnë ata, aq më shumë do të ndriçojë e ardhmja jonë e përbashkët.



Shkolla nuk është vetëm zbatuese e urdhërave, por matëse e rezultateve të mësimdhënies dhe edukimit



nga FRAN GJOKA

Zhvillimi i vrullshëm i shoqërisë së sotme si dhe rritja me ritme marramendëse e shpërndarjes së informacionit të pafund, kanë bërë që mësimdhënia të ndryshojë. Shkolla është bërë një institucion dinamik që po ndryshon shumë nga parametrat e saj të së kaluarës. Ky proces ndryshimi lidhet ngushtë jo vetëm me kontekstin ku ajo zhvillohet, por falë kohës së sotme e karakterizuar nga një globalizim gjithnjë e më i shpejtë që ndikon në rishikime të vazhdueshme të saj. Shkolla, si çdo institucion tjetër i mirëfilltë jo vetëm analizon veten, por vihet vazhdimisht në diskutim për të qenë si institucion fisnik i edukimi. Fusha e parë, në të cilën shkolla vepron, është përgatitja e një personeli sa më të efektshëm që të monitorojë jo vetëm procesin e mësimdhënies, por edhe të procesit edukues. Në këtë aspekt profesioni i mësuesit manifeston disa cilësi, që detyrimisht kërkohet të jenë në shërbim të procesit të mësimdhënies, ndaj suksesit i një mësuesi është njohja mirë e lëndës, e shoqëruar edhe me një sërë cilësish të tjera të aspektit të përgatitjes shkencore të tij. Procesin e mësimdhënies duhet ta shoqërojë saktësia në marrjen e materialeve dhe metodave që mësuesi kërkon të njohë, si: përcaktimi i objektivave mësimore, diagnostikimi i përgatitjes ditore të nxënësit dhe mjaft veprimtari të tjera të suksesshme që, detyrimisht, krijojnë një figurë ideale të tij në sytë e nxënësve dhe nxit e krijon me pak hapësira tek ata për të ndërhyrë në lidhje me ndërprerjen e mësimi. Autoriteti i mësuesit vihet në pah jo vetëm në mënyrë të drejtpërdrejtë por edhe të tërthortë duke u nisur si nga përgatitja e tij shkencore por mbi të gjitha nga aftësia dhe kapaciteti i tij për të shfaqur këtë përgatitje dhe aktualizuar, gjatë punës së tij individuale, për një mësimdhënie të personalizuar dhe në të njëjtën kohë duke paraprirë dhe përgatitur për më tej aspektin mësimor dhe edukativ. Bëhet fjalë në këtë proces për një shikim largpamës duke siguruar dhe injektuar në personin procese zhvillimi që i përshtaten prirjeve të tij por në të njëjtën kohë edhe realizimit jetësor. Mësuesi i shpreh aftësitë e tij praktike nëpërmjet një hulumtimi, i cili nuk i lejon nxënësit të harxhojë kohë me ndërhyrje në dëm të ecurisë së mësimi në klasë. Pra, një organizim i mirë i orës së mësimi ndikon edhe në rritjen e përgjegjësisë së nxënësit për mësimin, duke e vendosur atë në rolin e një partneri. Kjo nxitje e interesit të nxënësit për lëndën, do të rrisë ndjenjën e

punës në orën e mësimi dhe si pasojë, do të zgjojë tek ata interesin për mësim. Kjo situatë e ngrohtë dialogimi, detyrimisht, krijon një mjedis interesant për ecurinë e mëtejshme të mësimi. Ky angazhim i mësuesit në një punë të përditshme me klasën dhe ndihmesa e tij për zgjidhjen e problemeve të të nxënës krijon një figurë pozitive të mësuesit në sytë e nxënësve. Fokusimi i fjalës së mësuesit në procesin e mësimdhënies do të realizohet me nivel të lartë, kur ai do të mbështetet tek fakti se çfarë fjalori do të përdorë në orën e mësimi dhe se si do ta shfrytëzojë rastin e të folurit tek nxënësit. Atje ku ka hatërmbetje, konflikte, me mësues të papërgatitur shkencërisht dhe pa arsim përkatës të cilët dinë të urdhërojnë me inate, britma e nervozizëm, me predispozicionin e tij autoritarist, mbetet prezent në komunikimet e tij me nxënësit, gjë që sjell vetëm konfuzion në mes dy palëve. Në të gjitha rastet, çënimi i dinjitetit krijon një situatë të tensioni te pjesa e painteresuar e klasës. Kjo rrjedh nga fakti se nxënësit duke pasur status të njëjtë, shikojnë se mësuesi mund të fyejë me lehtësi njërin prej tyre e si rrjedhim, të gjithë ata mund ta ndjejnë veten të poshtëruar. Por, ngandonjëherë, tendenca që shfaq mësuesi për të fyer nxënësin pa asnjë arsye, mundet që, jo vetëm të mos pranohet përpara një situatë të tillë të humbë gjakftohësinë dhe, si pasojë, figura e tij çënohet e zhvlerësohet. Mësuesi i mirë nuk e toleron sjelljen e padëshirueshme të nxënësit dhe vepron menjëherë ndaj tij. Sjellja pozitive e mësuesit në klasë nënkupton që ai të dijë çfarë të kërkojë dhe çfarë të shpresojë nga nxënësit e tij. Ndodh që mësuesi të përdorë kërcënime si një element që ndihmon të kontrollojë orën e mësimi. Pavarësisht se mund të mos ketë shumë dëshirë që të përdorë si mjet kontrolli kërcënimin, në disa raste ai gjendet përpara faktit që të shikojë se “kërcënim” i sjell menjëherë efekt në kontrollin e klasës. Përvoja e shkollave tona tregon se mësuesit mbajnë qëndrim kërcënues në raste tepër të veçanta, kur ata janë të pashmangshme. Kemi raste mësuesish, të paktë në numër, që edhe abuzojnë me nivelin e kërcënimit dhe i tejkalojnë kompetencat që burojnë nga ligjet dhe aktet normative.

Me këto lloj kërcënimesh, asnjëherë dhe kurrë nuk jep rezultat në sensin pozitiv, se duke qenë hakmarrës krijon vetëm klimë konfliktuale. Mësuesi shpeshherë ndeshet edhe me raste apo situata ku mund të humbasë gjakftohësinë. Në këto momente tensioni mësuesi mund të mos e kontrollojë veten dhe thotë e bën gjëra jo normale, për të cilat më vonë mund edhe të pendohet. Duke parë nxënësi humbjen e vetkontrollit nga ana e mësuesit, mund të sjellë momentalisht një situatë qetësuese në mësim, por sjellja zemëruese nuk është mjet i dobishëm për efektivitetin e orës së mësimi. Nxënësi e ndjen veten të fyer dhe në rastin më të parë të tij, krijohet një situatë tensioni me mësuesit. Kur krijohen situata të tilla në mësim, mësuesi duhet të flasë prerë e qartë me nxënësit e tij. Duhet ta kuptojmë që metoda e të folurit në mënyrë të prerë me nxënësit nuk presupozon humbjen e gjakftohësisë dhe të kontrollit nga ana e mësuesit, por përkundrazi, shpreh aftësinë e tij për të menaxhuar saktë situatat në orën e mësimi. Aktualisht, e gjithë puna e shkollës mbështetet tek kurrikulat e reja dhe tek Karta

për të Drejtat e Fëmijëve, por kjo nuk është e mjaftueshme. Megjithatë, përsëri ushtrohet dhunë fizike dhe psikologjike. Nëse e para është drejt eliminimit, si rezultat i presionit të mjeteve të informimit dhe punës së madhe të trajnuesve dhe organeve qëndrore dhe lokale të arsimit, kjo e dyta mbetet përsëri e evidentë. E kërkon etika e mësuesit të trajtojë nxënësin si të barabartë mes të barabartëve, nga ana njerëzore, dhe të përpiqet me të gjitha mënyrat për të dhënë atë dije sa ai mund të përfitojë. Kjo arrihet duke përvetësuar normat pedagogjike, kurrikulat e reja, metodat bashkëkohore, vlerat humane, pa kërcënuar, pa fyer, pa i bërë presion nxënësit. Duhet ta kuptojmë se, edhe nëse një nxënësi të dobët i themi: “Me këtë përgatitje që ju bëni, rrezikoni të mbeteni në klasë”, është një presion psikologjik ndaj tij dhe ndikon negativisht tek nxënësit e tjerë. Detyra jonë është t’i japim kurajo nxënësit, të motivojë atë duke synuar që t’i krijojmë një ambient të ngrohtë, që ai të arrijë parametrat e mundshëm të përvetësimit të njohurive dhe të kulturës, sepse para së gjithash, kultura është një ideal që brumos jetën e njeriut, mbasi është shprehje e lirisë së individit dhe besnikërisë së tij ndaj vlerave të larta njerëzore. Ky duhet të jetë edhe qëllimi ynë i mëshiruar në profesionalizmin dhe përkushtimin për mësimin. Sa më i rregullt dhe imponues të jesh, aq më të matura do të jenë veprimet, aq më shumë mbresa do të lërë tek nxënësit e tij. Mësuesi duhet të jetë vetë dëshmitarë i dashurisë për të bukurën, për dijen, për demokracinë, për paqen. Ngrohtësia, të qenit miqësor dhe të kuptuarit e mësuesit, janë tiparet me të forta, të lidhura me qëndrimet e nxënësve ndaj lëndës. Me fjalë të tjera, mësuesit që janë të ngrohtë dhe miqësorë, kanë tendencë t’i kenë nxënësit dhe klasën si veten e tyre, pra, mësuesit shpenzojnë shumë kohë për të nxënësit, duke përmirësuar menaxhimin e klasës e duke i mbajtur ata të motivuar dhe të përfshirë.

Në një ditë mësimi, mësuesit i duhet të luajë shumë role, që detyrimisht i sjellin edhe strese, por në të njëjtën kohë edhe një numër kënaqësish. Kjo kënaqësi e punës së mësuesit është shoqëruar me kohën e zënë me punë. Veprimtaritë javore të mësuesit janë të panumërta, duke filluar nga ato rutinë e deri tek mësimdhënia.

Por, duke qenë një vlerësues i dijeve të tjerëve, shpesh mësuesi vihet në pozita të vështira, sepse sot kemi dy anë të realitetit: një mësues që përpiqet të punojë me përkushtim, dhe një nxënësi që sot punon pak, lexon pak dhe përpiqet të marrë atë që nuk e meriton. Kjo dukuri që plagë e tranzicionit, kurse tani mësuesit kanë avantazhe të tjera të suksesshme, si në stimulim material dhe në atë moral. Mësuesi udhëhiqet nga një kushtetutë – kod, që lejon lirinë e mësimi, të përdorimit të metodave, teksteve alternative ashtu si e mendon ai, dëshiron ai për të pasur rezultate sa më të larta. Dikur, mësuesi ishte burim informacioni, masë për gjithçka, ndërsa sot, ai është udhëheqës dhe organizues i mësimi që udhëheq nxënësin për ta kërkuar në mënyrë të pavarur informacionin dhe i pajis me metodologjinë, i zhvillon mendimin dhe gjykimin që të zgjidhë çdo problem, sado i ndërlikuar qoftë. Sot, në qëndër të mësimi është nxënësi. Mësuesi regullon e përshtat mësimdhënien dhe objektivat e saj me interesat dhe

nevojat e nxënësve.

Një kujdes i veçantë në matjen e objektivave të arritjes dhe të gjendjes aktuale është të vihet re jo vetëm niveli i përgjithshëm i klasës por dinamikat kryesore që shkaktojnë këtë mesatare të përgjithshme të nxënësve. Metoda e mësimdhënies dhe procesit edukativ me në qëndër nxënësin mbështet jo vetëm me një pjesë të nxënësve që ndikojnë pozitivisht apo negativisht në vizionin global të klasës por para së gjithash në studimin e të gjitha rasteve konkrete për të analizuar ndikimin që çdo element ushtron mbi tërësinë e klasës. Të flasësh për përqindje nuk ndikon pozitivisht në analizën konkrete të hallkave të ndryshme mësimore dhe edukative që përfshin jetën e nxënësit në klasë, marrëdhëniet me elementet e tjera jashtë klasës dhe veçanërisht aspektin familjar që luan një rol vendimtar në këtë proces. Një mësues i përgatitur shkencërisht nga ana didaktike dhe pedagogjike është i aftë ta shohë klasën në tërësi dhe në veçanti duke u nisur nga çdo element përbërës. Njeriu është, për nga struktura themelore e tij një qenie në marrëdhënie “me”. Dinamika e marrëdhënieve cilësohet pikërisht nga cilësia e marrëdhënieve që krijohen si në klasë gjatë procesit të mësimdhënies ashtu dhe jashtë saj. Nga sa u tha më sipër, problemi i procesit didaktik dhe edukativ ka ngjatur veçanërisht në trajtimin e problemeve të vazhdueshme përsa i përket mënyrës së sjelljes së mësuesit i cili: nuk duhet të kërcënojë, nuk duhet të bërtasë, nuk duhet të përdorë dhunën etj.; vihet re fare mirë se po punojmë vetëm në një nivel minimal të përgatitjes shkencore dhe pedagogjike, përkundrazi, trajtime të problemeve të tilla, mund të themi që, duhet të jenë kaluar me kohë nëse konsiderojmë faktin që bëhet fjalë për një shkollë edukimi dhe mësimnxënieje dhe jo për një institucion riedukimi për minorët, për të mos thënë paraburgimi.

Shkolla duhet ta pyesë veten: përse punohet vetëm në këtë nivel minimal dhe çfarë duhet të bëhet për të eliminuar problemin e mangësisë së profesionalitetit të mësuesit?

Shkolla nuk mund të kalojë nga mjeshtëri edukimi në nevojë edukimi për vetë personelin. Boshti kryesor që mbështet mbarë institucionin mësimor dhe edukativ spostohet keqas duke u munduar që të përballohen vështirësitë jo me nxënës por me mësuesit. Domosdoshmërisht shkolla shndërrohet në një spital që gjendet të përballojë çdo ditë vetëm problemet e urgjencave pa u munduar që të studiohen dhe analizohen gjërat thellësisht, në të cilin pasi jepet ndihma e shpejtë në shumë “inçidente shkollorë”, të kalohet te procesi i analizimit më të thellë, para së gjithash duke gjetur “doktorë” profesionistë të cilët injektajnë kura të vazhdueshme shërim.

Ja, kjo është shkolla: një sistem model i mirëfilltë ku çështjet e mangësisë së përgatitjes profesionale t’i ketë kaluar me kohë dhe të merret me problemin e vet, shkolla është për fëmijët dhe jo fëmijët për shkollën. Besoj se të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se një mësues i mirë përmirësohet çdo ditë në marrëdhënie me nxënësit, kolegët e tjerë, prindërit dhe institucionet e tjera të ngjashme por nuk duhet asnjëherë të spostohet boshti që mban gjithë këtë proces duke përballuar probleme me mësuesit në vend që të orientohej te objektivi kryesor që janë fëmijët.

Malësorët e Nën-Shkodrës, pjesë e pandarë e Malësisë së Madhe



Malësorët që erdhën në zonat bregdetare si nomadë aty nga fundi i shekullit të tetëmbëdhjetë/XVIII, sic thekson historiani Zija Shkodra, ngritën stanet e bagëtive në zonat e Malit të Shëngjinit, Malit Kolaj, Malit të Rencit, në kodrat e Zejmenit dhe në kodrat e tjera buzë Detit Adriatik.

Të parët erdhën shkrelasit, më vonë kelmendasit dhe banorët e malësive të tjera.

Siç dihet, deri vonë, fushat e bregdetit ishin kënetat dhe moçale. Me t'u larguar ujërat, ata (malësorët) zbritën drejt fushave. Ndërsa në shekullin e XIX dhe XX ata erdhën masivisht në zonat e lartpërmendura dhe morën toka e mbarështonin tufa të mëdha bagëtish.

Ata tashmë ishin autoktonë në fshatrat e tyre. Me të zbritur në këto zona, familjet e mëdha si Preloshajt, Cokajt, Sykajt, Turkajt, Makajt, Tahirajt, Loshajt, Patajt e familje të tjera filluan të ndërtojnë kullat e mëdha prej guri, të cilat shërbyen edhe si mburojë ndaj pushtuesve.

Në fillim të shekullit të XX, malësorët u bënë jo vetëm faktor ekonomik, por edhe politik në këto treva të Ultësirës Perëndimore. Në bashkëpunim me parinë e Lezhës, të Malësisë së Lezhës e të zonave të tjera, ata u bënë zotë të krahinave të Lezhës e të zonave të tjera bregdetare dhe ndikuan në luftën kundër pushtuesve turq e fqinjëve tanë serbo - malazez.

Kështu për shembull, në vitin 1912, në Lezhë u ngrit Qeveria me në krye Gjeto Cokun. Qeveria kishte synim kryesor mbrojtjen nga pushtimi serb. Ajo i kalonte kufijtë e zonës së Lezhës, duke u shtrirë deri në afërsi të Durrësit në Jug dhe të Shkodrës në Veri. Në Lezhë u ngrit flamuri i pavarësisë dhe Qeveria e Lezhës u bashkua me Qeverinë e Vlorës.

Ajo, që duam të theksojmë është se mbas dy – tre shekujve krahinat e Nën - Shkodrës, megjithëse fituan identitetin e vet krahinor edhe sot ruajnë traditat, doket e të folmen autoktone të Malësisë së Madhe.

Disa nga faktorët që kanë ndikuar për këtë janë:

Së pari, lufta e përbashkët që ata zhvilluan kundër pushtuesve turq e fqinjëve serbo - malazez. Kështu, në luftën për pavarësi që u zhvillua në Malësinë e Madhe e që solli ngritjen e flamurit në Deçiq, në vitin 1911, kanë marrë pjesë rreth 500 malësorë nga zona e Nën- Shkodrës.

Pas shtypjes së kryengritjes së vitit 1911 lufta kundër pushtuesve turq u përqendrua kryesisht në zonën e Nën- Shkodrës si në Bregun e Matit, Lezhë, e të tjera.

Në bashkëpunim me krerët e Malësisë së Lezhës, Rubikut, Kurbinit, e të tjerë, në vitet 1911, 1912 u zhvilluan luftime të ashpra kundër pushtuesve turq për çlirimin kombëtar e shpalljen e Pavarësisë.

Janë të njohura kuvendet, që janë zhvilluar në vitin 1912 në Zejmen, Shënkoll, e të tjera, për të lidhur besën e luftuar kundër armikut.

Po kështu beteja të tilla si beteja e Lezhës ku u shkatërrua plotësisht ushtria turke e qytetit, beteja tek kullat e Llesh Nikë Dakës, të cilën shtypi i kohës e ka krahasuar me betejën e Termopileve dhe Lleshin e ka quajtur si "Leonidha" i Bregut të Matit, beteja tek Trapet e Gurësit, në qershor 1912, ku u shpartallua plotësisht një tabor i ushtrisë turke, flasin për luftërat e mëdha që janë zhvilluar në këto treva.

Vlen të përmendim faktin që vetëm Lezha, me rrethinat e saj i ka dhënë luftës për pavarësi nga Perandoria Osmane, 46 dëshmorë, 4 nga të cilët i përkasin familjes së Llesh Nikë Dakës të Bregut të Matit.

Së dyti, shtegtimet e përvitshme të malësorëve të Nën-Shkodrës drejt Malësisë së Madhe. Këto shtegtime bëheshin për dy arsye: Së pari, për të jetuar në trojet e të parëve e pranë njëri - tjetrit dhe Së dyti, zonat e Nën Shkodrës ishin mjaft të vështira për të thënë të pamundura për të jetuar gjatë stinës së verës pasi sëmundjet si malaria dhe sëmundjet e tjera ngjitesë bënin "kërdinë" në popull. E për rrjedhojë nga muajt prill, maj fillonte "kalvari" i përvitshëm i malësorëve drejt Malësisë së Madhe.

Me "rob e robi" e gjënë e gjallë udhëtonin për ditë të tëra drejt bjeshkëve të Kelmendit e Shkrelit e malësive të tjera për të veruar atje deri në muajt shtator e tetor të çdo viti.

Shtegtimet krijuan mundësinë që malësorët të njiheshin e të lidheshin me shumë me njëri - tjetrin e të martoheshin

pedagogjisë.

Meqe jemi në epokën kulminante të komunikacionit do ishte shumë e nevojshme që të krijohej një portal i rëndësishëm si nga ana e Ministrisë së Arsimit por edhe e Drejtorive Rajonale ku të hapet një diskutim dhe dialogim (jo kritikë shkatërruese) mbi problemet që mësimdhënia has në vendin tonë si dhe sygjerrime të ndryshme nga specialistë të ndryshëm, që ndoshta "fati" nuk ua ka hapur rrugën për të ushtruar profesionin në këtë fushë, por që në pjesëmarrje të lirë, demokratike dhe etike të përgjegjësisë mund të na japë

e të krijojnë familje me vajzat nga Malësia e Madhe e anasjelltas.

Deri në ditët tona jetojnë shumë gra që kanë ardhur nga Malësia e Madhe e që ishin e janë "sokolesha" e "zonja" të vërteta. Madje disa prej tyre kanë bërë edhe rolin e zonjës së shtëpisë siç e kanë tradit malësorët, gra të moshuara e të mençura menaxhonin të ardhurat e shtëpisë, organizonin pritjen e miqve e të tjera.

Po kështu bija të malësorëve nga trevat fushore u martuan në Malësinë e Madhe, çfarë ka ndikuar e që edhe sot ndikon në lidhjen mes të dy krahinave.

Shumë njerëz të brezit tim, përfshirë edhe mua, që kemi lindur në periudhën e verës, kemi lindur na Malësinë e Madhe çfarë ka sjellë që ti duam ato zona si vendlindja jonë.

Së treti, kultura dhe arti si pjesë e identitetit të popullit kanë luajtur një rol të madh në ruajtjen e lidhjeve ndërmjet Malësisë së Madhe dhe trevave të Nën Shkodrës.

Këngët, vallet, veshjet, e të tjera, janë ruajtur me kujdes në festat familjare, veprimtaritë lokale e kombëtare. Kështu bie fjala, në të gjitha veprimtaritë që janë zhvilluar në Lezhë, deri në festivalet e Gjirakastresë së bashku me zadrinorët e mirëditorët, malësorët kanë pasur një vend të rëndësishëm në këto ansamble me këngët, vallet e veshjet e tyre.

Kënga "për maje krahut", vallja e shpatave, vallja e logut, lahuta, xhubleta e veshje të tjera nuk kanë munguar në këto veprimtari.

Këto treva kanë nxjerrë lahutarë me emër si Gjon Nikollë Sokoli, Ndue Lulashi, Llesh Prekushi, Pjetër Matusha, Gjelinë Noni, e të tjerë, që aq bukur i kanë kënduar dhe i këndojnë këngët epike që janë frymëzim për brezat.

Është për tu theksuar që këngët e vallet popullore po i mëson brezi i ri, çfarë flet për pavdekësinë e tyre.

Së katërti, me Malësinë e Madhe janë marrë shumë personalitete të huaj e shqiptarë. Malësorët janë vlerësuar nga Edit Durham, Franc Nopça e të tjerë. Për malësorët kanë shkruar e folur shumë shkrimtarë të shquar. Dua të veçoj dy prej tyre, Patër Gjergj Fishtën, që me veprat e tij e sidomos me "Lahutën e Malësisë" ka ngritur lart vlerat e tyre, çfarë ka shërbyer si frymëzim për brezat.

Ndërsa dramaturgu i kohës tonë Fadil

Kraja, i cili subjektin e veprave të tij e merr nga Shkodra dhe rrethinat e saj, ka sjellë në memorien tonë traditat, doket, figurat e burrave dhe të grave që kanë dalë bashkë me burrat në kuvendet e në luftë për mbrojtjen e trojeve shqiptare.

Kanë mbetur në histori figura të tilla si Nora, Tringë Smajlja, Zojë Nikë Daka e shumë gra të tjera.

Pa mohuar çfarë thashë më sipër e çfarë mund të thuhet më shumë për këtë problem, mendoj se në të ardhmen disa gjëra duhen parë e vlerësuar më mirë e më drejt.

Duhet të shpeshtohen takimet, vajtje – ardhjet nga fusha në Malësinë e Madhe dhe anasjelltas. Nuk justifikohet fakti që mjaft njerëz nga Nën Shkodra, megjithëse janë në moshë të madhe e po plaken nuk kanë shkuar qoftë edhe një herë në fshatrat e Malësisë së Madhe ku kanë origjinën e ku ju ka "lindur koka".

Të rëndësishme janë lidhjet farefisnore.

Megjithëse koha ka bërë të sajën, brezat janë larguar, ato duhet të kujtohen e mundësisht të krijohen lidhje të reja farefisnore e martesore aty ku krijohet mundësia.

Emigracioni ka larguar shumë të rinj dhe të reja nga Mbi Shkodra e Nën Shkodra, por atje ku janë nga të katër anët e botës t'i kërkojnë lidhjet e tyre farefisnore e miqësore.

Disa këngë të moçme si "kënga e maje krahut" e disa vegla muzikore si lahuta e fyelli duhet të ruhen më mirë.

Ndonëse shumë prej nesh krenohemi, që na ka lindur xhubleta, duhet thënë se edhe kjo veshje kaq popullore e me emër nuk ekziston në shtëpitë tona. Xhubletat i shohim vetëm nëpër muze apo veprimtari. Kam dëgjuar që shumë shqiptarë që kanë emigruar i kërkojnë

Kam dëgjuar që shumë shqiptarë që kanë emigruar kërkojnë që këto simbole ti gjejnë, ti mbajnë e ti përdorin në shtëpitë e tyre dhe t'i përdorin në veprimtaritë që zhvillojnë.

Atëherë shtrohet pyetja, kur ato i kërkojnë dhe i mbajnë shqiptarët që jetojnë në SHBA, Gjermani e gjetkë, si të mos i mbajnë e praktikojmë ne që jetojmë në zonat e origjinës së tyre?!

***Dr. Marash NDOKA**

Lezhë, 2025

◀ Sigurisht që për të arritur të gjithë synime duhet të ekzistojë një bashkëpunim i mirë jo vetëm në shkollë por duke filluar që nga hallkat kyçe që janë Ministria e Arsimit dhe Drejtoria Arsimore. Një shkollë pararojë nuk është në këtë rast vetëm një ekzekutuese e urdhrave por edhe një matëse e mirë në terren, i rezultateve të mësimdhënies dhe edukimit duke bashkëpunuar me hallkat kryesore të arsimit që të jetë përcuese e vazhdueshme e këtyre rezultateve dhe e sygjerrimeve të metodave të ndryshme që ndihmojnë procesin e didaktikës dhe

sygjerrime mjaft promovuese dhe zhvilluese në këtë fushë. Sigurisht që një profesionist i aftë e tregon aftësinë e vet edhe në komunikimin ndërtues dhe etik që vë në pah përgatitjen reale profesionale të tij. Ky mendoj se është problemi madhor që shkolla shqiptare po kalon me vite: ku ndodhen sot mësuesit e aftë? Ku t'i gjejnë drejtuesit ose manaxherët e vërtetë? Secili prej nesh në jetën e përditshme e vë re, pa pasur nevojë të jemi kritikë, që ekziston një emigrim i inteligjencës në fusha të ndryshme që nuk janë të tyre; nuk bëhet fjalë vetëm për një emigrim jashtë vendi por në hallka të

ndryshme që mund të jenë fusha e biznesit apo dhe në fusha të tjera ku nuk mundësojnë kontributin maksimal të tyre. Të flasësh për shkollën në Shqipëri nuk mund të mos flasësh për politikat që përdoren.

E lë të hapur këtë temë dhe i besohem lexuesit të aftë që ndoshta, mund të shpresohet, të jetë ndër ata që realisht janë në gjendje të sjellin kontributin e tyre në ndryshimin e politikave për një personel sa më të përgatitur të brezit të ri, që sigurisht secili prej nesh ka elemente, në ambientin familjar, të këtij brezi të ri.

Armiku më i rrezikshëm, është ai që harrohet

Duke u kthyer në vitet e largëta, në vitin 1967 të luftës në lindjen e mesme, Izraeli luftonte me koalicionin Egjipt, Siri e Jordani.

Shkak i këtij shkrimi u bë një ngjarje e jetuar. Isha me shërbimin ushtarak në Brigadën e Nëndetëseve. Konkretisht në Nëndetësen e pare, me komandant Aleko Pojani dhe komandant të Brigadës Mark Plani. Lundrimin e filluam me 5 qershor dhe u kthyem në bazë, në Pashaliman, me 12 qershor të vitit 1967. Në kohën kur edhe përfundoi lufta. Detyra luftarake për nëndetësen e pare ishte lundrimi në ujërat neutral, duke qëndruar mbi ujë. Përgatitja e efektivit ishte në nivelin që kërkonte situatë. Optimizmi i secilit marinar ishte në plotësimin e detyrës maksimalisht, që ishte ngarkuar nga komanda.

Kjo luftë quhej lufta e tretë Arabe - Izraelite. Marrëdhëniet nuk ishin normalizuar qysh në vitin 1948. Dëmet ishin të konsiderueshme sidomos në anën e vendeve Arabe. Forcat Izraelite shkatërruan mbi 248 avion nga 400 që kishin gjithsej. Gjatë luftimeve mbeten 20 000 viktima nga vendet Arabe; ndërsa nga ana Izraelite mbeten rreth 1000 viktima.

Duke lundruar në ujërat neutral, me datën 7 qershor 1967, bëhet mbledhja e shtabit të anijes. I pranishëm ishte edhe Komandanti i Brigadës, Mark Plani. Në mbledhjet e komandës merrnin pjesë shefat kryesor, por edhe sekretari i rinise, që isha unë. Specialiteti imi ishte radio-telegrafist.

Në një moment më jepet urdhri, që të ngrihet antena e gjatë që quhej antena fill. Ajo, që u tha në mbledhje, kur dola në urën komandimit i pashë në mënyrë vizive. Anie gjigante, avion e të tjerë. Sa u ktheva në postin luftarak, pra në kabinën e radio telegrafisë, me jepet urdhri për të transmetua një radio sinjal, gjë që ndodhte shumë rrallë. Kuptova se ishte diçka serioze.

Në postin luftarak të ndërlidhjes nuk lejohej të futesh askush përveç efektivit, që ishim tre veta dhe Komandantit të qendrës së ndërlidhjes. Radio sinjali ishte 222, 222, 222, që i drejtohej FLD (Fllota Luftarake Detare) dhe Ministrisë së Mbajtjes.

Emocionet ishin të jashtëzakonshme. Mbase edhe mosha e re e bënte të veten, isha vetëm 21 vjeç. Si do e transmetojë, si do e marrin e të tjera pyetje që i beja vetes. Vërtetohet se radio - sinjali u mor nga

telegrafistet e FLD. Edhe sot, pas 58 vitesh më kapin emocionet. Duhej të ndërroja antenat, u ngjita në urën e komandimit dhe pash se avionët që fluturonin mbi anijen tone u zhduken.

I shkrova këto mbase edhe sekrete! Po ato nuk janë sekrete tani më, se as Nëndetëset? Nuk kanë as nam as nishan. Ato



që deri dje ishin krenaria e jonë, sot!?!?!.

Vendin tone duhet ta mbrojmë vet, jo të presim çdo gjë, nga aleatet.

Këtë shkrim, nuk e shkrova për të treguar për vete, sepse si unë kanë shërbyer me mijëra marinar në FLD, por për të treguar një nga mijëra episode, të cilat ishin për mbrojtjen e atdheut. Investimet në fushën mbrojtjes ishin në maksimumin e mundshëm. Duke ndjerë rrezikun e ndonjë lufte të mundshme, ku nuk janë të pakta rastet, kur ne jemi sulmuar nga fqinjët, por edhe nga fuqi të mëdha.

Po japë disa të dhëna, jo për nostalgji për Diktaturën, por "Çezarit" ti japim atë që i takon.

Në vitet 1980-1990, Ushtria jonë kishte 7 korpuse, 74 brigada, nga këto 12 ishin brigade artileria, 10 brigada tankesh e 3 regjimente avionësh me 152 avion të tipave të ndryshme. Ushtria shqiptare kishte në dispozicion 1100 tanke e blindat. Në këto vite FLD kishte 145 anije dhe 4 nëndetëse të përqendruara në gjithë bregdetin Shqiptar. Në investimet e mëdha

për mbrojtjen, një vend të rëndësishëm zinin edhe fortifikimet. Në të gjithë vendin ishin ndërtuar rreth 230 mijë qendra zjarri. Të dëmtuara në sy të të gjithëve, shteti bënte sikur nuk shihte, kur që duhet të ndërhynte, për t'i ruajtur. Duhet inventarizuar e bërë funksionale, ato të cilat i kanë rezistuar kohës. Ishin dy fabrika për prodhimin e armëve e municioneve e të tjera.

Ka gazetar dhe analistë, të cilët nxinin çdo gjë, që është bërë për mbi 40 vjet! Pa thënë një fjalë të mirë. Populli thotë se as "dreqi" nuk është aq i zi sa thonë. Ndonëse të mirat ishin me pikatore, në krahasim me vuajtjet e popullit nga regjimi diktatorial. Po investimet e bëra në fushën e mbrojtjes kanë qenë të duhura. Vend strehimet e ndërtuara për mbrojtjen civile, ishin prioritet, se në luftë shkon më i qetë, kur pleqtë, grat dhe fëmijët janë në vende të siguruara, në vend strehime.

Po sot ku jemi?

Nuk e cilësova kot ato që kanë ndodhur në vitin e largët të vitit 1967. Investimet në ushtrinë tone, nuk i bënim për të frikësuar as NATO-n dhe as Traktatin e Varshavës, po për të tregua se jemi të vegjël, por të fortë.

Duhet të pranojmë se ushtria jonë është modernizuar me armë të lehta, automjete luftarake, avion, mjete ujore, artileri e mjete transportit. Ne duhet të pranojmë, këto armatime e mjete ushtarake, janë të plota, për të përballuar ndonjë agresion të mundshëm nga fqinjët tone, të cilët historikisht kanë pas ambicie.

Duhet të pranojmë se, gjatë tranzicionit të stërzgatur të vendit tone, Armatimet dhe pronat e ushtrisë kanë qenë shënjestra e grabitjes së tyre. Pretendimet kanë qenë nga më të ndryshmet, se armatimet janë të vjetruar, pavarësisht se një pjesë e madhe e tyre përdoren ku do në botë edhe sot. Mbase me propagandën e bërë për armatimet edhe pranohet, se me propagandë jemi mbushur deri në fyt.

Po për pronat?

Këto prona, të cilat fillimisht u shkaruan nga duar kriminele, pastaj filluan privatizimet e tyre. Po kush i përfitojë pa drejtësi, grupet kriminale të lidhura me politikën. Kjo vërtetohet edhe se një pjesë e madhe tyre janë venë nënë sekuestro. Këto prona të lakmueshme janë në breg det dhe në emër të paketës se maleve, ka mundësi pre këtyre të bien edhe pronat

e trashëguara brez pas brezi. Kjo duket që është edhe arsyeja që nuk zbatohet Vendimi i Qeverisë nr. 20/20 "Për dhënien e çertifikatave të pronësisë", ndonëse janë plotësuar e gjithë dokumentacioni e janë dorëzuar në bashki.

Në emër të investitorëve strategjik mashtrimi i radhës!

Anëtarësimi i vendit tone në NATO, është një arritje e madhe. Në vitin 2024 Shqipëria është renditur në vendin e 20-të në realizimin e shpenzimeve për mbrojtjen në kuadrin e 2 perqind të prodhimit bruto, nga 32 vendet e NATO-s. Për vet pozitën gjeografike, ne duhet të jemi vigjilent dhe të njohim historinë, sa here jemi sulmuar. Prandaj investimet për mbrojtjen nuk janë të tepërta. Gjithashtu e rëndësishme është përzgjedhja e efektive që shërbejnë në ushtri.

Rekrutimi i ushtarakeve sipas bindjeve politike është gabim i rende, se Forcat e Armatosura janë me kushtetuta të depolitizuar. Uniformen ushtarake duhet ta veshin ata që e meritojnë. Të mos ndodh, ku brenda rrethimit të territorit ushtarak të kultivohen lëndë narkotike, siç ka ndodhur në Zallher para disa viteve, duke rekrutuar në forcat e armatosura militant. Në mesin e tyre infiltrojnë edhe element të lidhur me krimin. Ashtu si në të gjitha fushat e tjera. Shpërdorimet në fushën e mbrojtjes, kërkojnë vënien para përgjegjësisë cilindo qoftë ai pushtetar apo kriminel. Të mos mjaftohemi me sekuestro, po të bëhet konfiskimi i plotë i tyre. Abuzuesit me këto pasur, të cilat janë djersa e këtij populli. Të shkojnë atje ku e kanë vendin.

Faktor i rëndësishëm, në forcimin e sigurisë kombëtare, kthimi i syve nga bujqësia, e cila pas reformës së "famshme" territoriale. Prodhimi bujqësor e blegtoriale ka rënë. Tokat janë djerr, blegtoria e përgjysmuar, mbështetja për bujqësinë e papërfillshme. Në blegtoriale mbase ka ndikuar edhe mos "ngritja e akademisë së blegtorëve" premtim i pa mbajtur nga Ministria e Bujqësisë!?!?!?

Bashkitë kanë problem të tjera, deri sa të i vijë radha bujqësisë.

Miratimi i kapitullit të 5 i vendosur në Hagë është një ogur i mire për mbrojtjen në bllok të anëtareve të NATO-s. Kjo nuk duhet të na vendosë në gjumë. Larg qoftë i ndonjë sulmi të mundshëm të jemi të përgatitur fillimisht deri sa të zbarkojnë forcat e bllokut.

Lajm i mirë, për ne është organizimin e samitit të NATO-s, në vendin tonë në vitin 2027. Ne duhet të bëjmë detyrat tona sa ma mirë, deri në pritjen e organizimit të Samitit.

*Përgatiti Ndue Ziçi,
Lezhë, tetor 2025

Fran Çardaku - Një jete mes mësimi, artirit dhe alegrisë!

Prele Milani

Me date 21. 10. 2025 u nda nga jeta Fran Çardaku, 79 vjeç, një njeri që kurrë nuk e pranoi barrën e rëndë të moteve. Që në rini u shqua si djalë i pashëm, trendi, i zgjuar dhe plot energji. Aktivist i kulturës, studiues i pasionuar, fizarmonicist i zoti,

këngëtar, valltar i shkathët dashamirës i natyrës dhe ekskursionist novator.

Si profesor i historisë dhe filozofisë në Shkollën e Mesme "Mehmet Shpendi" në Breg-Lum, por edhe metodist i mësimdhënies dhe më gjerë në Dukagjin dhe rrethin e Shkodrës, i dhuroi shkollës mbi 35 vite të jetës së tij më vitale. Ai e shoqëroi shumë breza nxënësish, duke lënë gjurmë të paharrueshme në formimin e tyre intelektual dhe moral e kulturor. Bashkëshort i kujdesshëm, prind i dashur, admirues i së

bukurës dhe i alegrisë, Fran Çardaku ishte një nxënës i devotshëm i Dionisit: çmonte më pak "shpatën" se gotën, por më shumë penën dhe dinjitetin.

Fran Çardaku që sot nuk është më fizikisht mes nesh, por kujtimi i tij si intelektual, mësues, njeri i këngës, humorit, artist dhe babaxhan social, do të jetojë në zemrat e atyre që e njohën. Ky kujtim duhet t'u transmetohet të rinjve, jo për kortezi, por si një vlerë që duhet respektuar. Pushofsh në paqe, profesori i modan i Dukagjinit!



HUMBJA PA KTHIM ...

Kaluan ditë, javë dhe muaj që familja e Lekë Ndreshajt nga Torovica e Lezhës me ankth e dhimbje në zemër kërkon kryefamiljarin, fëmijët kërkojnë prindin, Duakagjini kërkon të birin dhe Torovica kërkon bashkëfshatarin e vet.

Leka, babai i katër fëmijëve, gjysh i disa nipave e mbesave, nip në Brashtë - Shoshit, ashtu si pothuajse shumica e prindërve në Shqipëri, jetonte prej vitesh vetëm me bashkëshorten, Katrinën, mbasi fëmijët i kishte në emigrim jashtë vendit.

Lekë Ndreshaj, me banim në Torovicë të Lezhës, me origjinë nga Nënnavriqi i Shalës në -Dukagjin ka dalë nga shtëpia me datën 9 qershor të këtij viti, për të marrë pjesë në ceremoninë mortore të mikut të tij, në Malësi të Madhe dhe prej asaj dite nuk u bë ma i gjallë, nuk u kthye ma pranë familjes e të afërmeve të tij.

Leka nuk u ndie mirë gjatë qëndrimit në varrim të mikut të tij dhe kërkoi ndihmë ta çonin në shtëpi. Kur nuk gjeti një person ta shoqëronte, vendosi të largohej i vetëm, flitet se është parë dukë kërkuar automjet drejt Shkodrës, por e vërteta mbeti në errësirë prej disa muajsh. Me mall e lot në sy, familjarët të shqetësuar kërkuar dhe vazhdojnë të kërkojnë, duke dhënë kushtrim anembanë vendit, në të gjitha mediat, në Malësi të Madhe, në Dukagjin dhe anembanë Shqipërisë, por kërkimet nuk kanë dhënë asnjë rezultat...

Shumë aluduan, duke dhënë informacione të rreme, duke ngritur shpresa mbi dhimbje e të tjerë heshtën të shqetësuar, mbasi e vërteta rezultoi e hidhur pa asnjë përgjigje.

U mblodhën fëmijë, të afërm, shokë, miq e dashamirë, pasi Leka kishte aq shumë, por më kot ...

Djali i tij Gëzimi mes lotësh për humb-

jen e të atit, rrëfeu zemrën e tij në emision, duke ofruar një shumë të madhe parash, veç ta gjente babanë e ta kishte përsëri pranë, por çdo përpjekje rezultoi e kotë.

Sot në këtë familje ka pllakosur dhim-



bja së bashku me misterin e humbjes së një burri, një babai, një kryefamiljari, një vëllai, një shoku, një bashkëfshatari, një miku e një kumbare.

Dhimbja dhe shqetësimi për Lekën kanë kaluar kufijtë e familjes dhe të të afërmeve, ajo dhimbje ka pllakosur anembanë bashkësinë, secili banor i fshatit Torovicë jeton me shqetësimin e hum-

bjes së mistershme e tij, pasi Leka si një person shumë i dashur, gjithmonë i qeshur e dashamirës, gëzonte respektin e të gjithëve.

Përtej çdo dhimbjeje po jetojmë përditë me pasigurinë e jetës, të fëmijëve e të familjarëve tanë.

Kaluan disa muaj që familjarët i kanë sytë nga dera, në pritje të shfaqjes së njeriut të zemrës, për t'i dhënë fund kësaj ëndrrë të ligë, kësaj nate të zezë, këtij lajmi të kobshëm.

Kur vajza erdhi nga kurbeti, duket se lotët lëshuan edhe muret e shtëpisë, ajo e kërkonte babin, zemra e saj ndihej bosh, pasi e donte me gjithë shpirt ashtu si çdo bijë e do babin e vet, lotët e saj nuk patën të ndalur, duke depërtuar ndër kujtimet e tij, duke parë dhomën, rrobat e fotot e të atit në mur, ajo nuk mund ta besojë se i ati nuk kthehet ma...

Ai nuk ishte i sëmurë, ai nuk u shua në aksident, ai nuk vdiq në krevat, ai nuk u qa nga familja, ai nuk u varros, ai iku e nuk u kthye ma...

Ku është vallë babai?

Ku u zhduk?

Kush e pa?

A mos e humbi dheu?

A mban kjo tokë një person që e di realitetin e këtij misteri?

Këto e të tjera pyetje i mundojnë familjarët çdo ditë. Ata nuk e kanë harruar dhe kurrë s'mund ta harrojnë, por thjeshtë po mësohen me realitetin e hidhur ...askujt s'i pati borxh dhe kurrë s'e meritoi këtë të zi fat...

Besoj se, ka një Zot, që i di të gjitha përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe herët a vonë do e nxjerrë në dritë të vërtetën sidoqoftë ajo. Vetëm syve të atij si shpëtojmë dot, sado të mendojmë, se ka një Zot që do ja prishë gjumin atij që e di të vërtetën, ai nuk do ta lërë të heshtë, ai duhet të hedhë dritë mbi realitetin, një ditë do dalë të thotë: "Po unë e di ...!" Nëse ka ndodhur

diçka aksidentale, le të na tregojë, ne jemi njerëz, e mbi të tjera jemi dukagjinas, ne dimë të falim me burrëri, por jemi hakmarrës nga padrejtësitë...

Vërtetë është e dhimbshme, por jo kaq e dhimbshme, pasi të gjithë jemi vdekatarë, ne duam një varr, një vend, ku të mblidhemi, të qajmë e të vajtojmë sipas traditës. Një foto e një emër mbi mermer, ta dimë se Leka, prehet i qetë diku mes lulesh shumëngjyrëshe, sjellë nga fëmijë, nipa e mbesa që e deshën aq shumë, ashtu siç e meritonte...

Në çdo ditë të jetës, kur dielli lind dhe perëndon pa dhënë përgjigje, shpirti ynë, që kemi humbur të dashurin e zemrës sonë, jeton në një pasiguri të pafundme. Kemi humbur mëngjesin dhe tretur në errësirë e një nate të gjatë pambarim ...

Shpirtin na plagosin pyetjet që vinë si një mollë e helmuar: Ku është? A do kthehet? Deri kur do presim?

Për familjen, secili moment kalon me një njësoj ankthi nuk ka festë e as gëzim. Shtrati i tij është bosh, fotoja e tij qëndron në mur, por është më shumë një kujtim që digjet çdo ditë, si një flakë që nuk mund ta shuash kurrë.

Kujtimet e tij janë anembanë: në shtëpi, në bahçe, në rrugë, gjithkund ku këmba e tij shkeli në jetë.

Shpresa është ajo që vdes e fundit në jetë, jemi ende më shpresë, se dikush do na thotë të vërtetën.

Ne besojmë në Zot dhe Zoti do e thotë të vërtetën, herët a vonë e vërteta do dalë, por dhimbja po na shkatërron ...

Përditë po presim një telefonatë, që do të thotë të vërtetën dhe sytë na rrinë nga dera, me shpresë...

LULË BREGU (PRRONI),

mësuese, në shkollë 9-vjeçare,

Torovicë, Lezhë

Një libër që të “mbërthen”!

Është libri, i botuar së fundmi nga “BOTIMET FISHTA” dhe pa mëdyshje, nga një autor që deri tash së fundmi nuk ishte i ardhur në shqip, bëhet fjalë për Imzot Leone G. B. Nigris, Delegati Apostolik në Shqipëri në vitet (1938-1944) që shërbeu si misionar dhe diplomat i shtetit të Vatikanit duke na dhënë si pakkush një libër të çmueshëm “Shënime mbi ngjarjet në Shqipëri”(1938-1944), parathënia për botimin shqip, shkruar nga Prof. Dr. Romeo Gurakuqi.

Famullitari i Shkodrës, Dom Vlash Palaj, duke bërë një hyrje për librin, në fund shkruan: “Ftoj lexuesin që, me një mendje të hapur dhe sy kritik, të ndjekë rrëfimin e këtyre ngjarjeve dhe të formojë gjykimin e vet mbi këtë faqe komplekse të historisë sonë”.

Prandaj, kjo ftesë më bëri që të ”mprehë” lapsin dhe thujse të gjitha faqet e librit ti shënjoj me apostile anash.

Në të vërtetë, nuk ka libër që sapo ta marrësh në dorë për ta lexuar, nuk të mbërthen, nuk të grishë të përfshihesh në emocione dhe informacione që të jep, që të shtyn ta mbarosh se të pret tjetri në radhë. Ndodh sot më shumë se kurrë nga moria e librave që mbushin stendat e li-

brarive tona.

Ishte një ngjarje e shënuar te Salla "Mikel Koliqi" në Famullinë “Zoja e Shkodrës” pranë Katedrales së “Shën Shtjefni” (20 shtator 2025), ajo e mrekullueshmja Kisha e Madhe e Shkodrës, ndoshta katedralja më e madhe në Ballkan, krenari e qytetit tonë, tempull stoik i ndërtuar me shumë sakrifica nga populli shkodran, jo vetëm katolik, por i “bekuar” edhe me ferman sulltanor në vitin 1858, ka njohur edhe “plagë” në trupin e saj, që nga predhat malazeze të Rrethimit të Shkodrës në 1912-1913, e më shumë, kur barbaria komuniste e kthej në Pallat të Sportit.

Por ajo katedrale, jetonte si dëshmi e fesë, si shtëpi e zotit, si monument i kulturës së mbarë popullit shkodran, por edhe si vendtakimi i parisë fetare dhe popullit të Shkodrës në momente kritike të ekzistencës së tij, moteve.


Libri nuk ka formën e një ditari, dhe autori nuk është thjeshtë një shkrimtar, por duke qenë në fillimet e veta meshtar në moshën 25 vjeçare por edhe profesor i matematikës në gjimnaz dhe në Seminarin e Udines (Itali), e ndërton librin në formën e shënimeve thujse çdo ditë, prandaj libri nuk ka kapituj apo edhe ndonjë stu-

dim, por shënime nga detyra e tij si diplomat i Vatikanit në Shqipëri duke vëzhguar politikën e qeverive shqiptare që asokohe, binin dhe formoheshin edhe brenda ditës, në kushtet kur vendi po kalonte ndoshta kohën e tij më të vështirë, vitin e fundit të mbretërimit të Ahmet Zogut dhe Luftën e Dytë Botërore, rënien e dy fuqive të mëdha pushtuese, Italinë fashiste dhe nazi - fashtistët gjerman dhe ardhjen e forcave partizane si fituese të asaj lufte, por edhe si pushtet i ri pa trajtë të përcaktuar mirë të regjimit mbas lufte.

Ne, shqiptarët e vitit 2025, që kemi një moshë dhe jemi shkolluar herët në një periudhë kur të vërtetat nuk ishin pronë e të gjithëve, por jepeshin ato që i duheshin sistemit 50 vjeçar në funksion të pushtetit të tij, por edhe botimet alternative në qëllim për të vërtetën mungonin, ardhja e librit në fjalë, leximi i tij me vëmendje që nga faqja e parë, të futë në disa “drithërima” në raport me leximet e mëparshme që kanë një plan tjetër të trajtimit të së njëjtës ngjarje, sepse fokusi i Imzot Nigris është parë me moralin e tij kristian për të vërtetën dhe besimin, jashtë asnjë in-

teresi veç detyrës së tij të përmbysë besim që Papa Piu XI i besoj si përfaqësues i tij në Shqipëri në një kohë kritike e historike.

Kështu nga këto premisa dhe nga fakti se kush ishte autori, e mora librin, e lexova, e nënvizova për të gjykuar edhe unë mbi ato ngjarje me aq sa kam njohuri nga shkrimet e tjera, qoftë ato shkollore të dikurshme, qoftë të personaliteteve shkrimtar veshur me petkun e një prifti katolik që nuk janë pak, por edhe laik, akademik edhe të huaj që janë marrë me historinë e Shqipërisë së 80 viteve të fundit.



Poezi nga Manushaqe Laçi *** Poezi nga Manushaqe Laçi *** Poezi nga Manushaqe Laçi



NËSE ASHT DASHNI

Kur m' sheh me ato sy, fshehurazi m' ledhaton,
Pa za më flet, por çdo fjalë ma trazon,
Si mëkat i amël që s'dua t' harrohet, më josh, më magjepson.

Kur afroresh pranë, koha merr tjetër kthesë,
Si t' ishe shenjë në fat, një lojë apo shpresë,
Nëse kjo asht dashni, le t' digjet pa asnjë pendesë.

Ti vjen si era, s'pyet, veç më çrregullon,
Më prish flokët, mendimet, si fëmijë gëzon,
Por unë buzëqesh, m' pëlqen kur m' ngacmon.

Në sytë e tu ka diçka që m' tërheq të luj,
Si një fjalë që s'thuhet, ndonse pak m' ban t' vuj,
Nëse kjo asht dashni, le të jetë e çmendme, e ashtu m' duj.

Ti më çudit, si pranvera kur mes dimrit vjen,
Me at buzëqeshjen lozonjare, seç m' ngazëllen,
Ç' magji ke në shpirt, që me forcë m' mbërthen!

Nëse kjo asht dashni, hajde ta çmendim dhe pak,
Është histori që s'shkruhet, pa të ndjenjës gjak,
Mes puthjesh t' na trazojë, si era tymin n' oxhak.

Ti je ai fladi i lehtë, që pa zhurmë më prek,
Në sytë e tu shoh botën, që ngazëllueshëm më ndjek,
Nji zemër që rreh butë, mes heshtjes më flet.

Ti m' nguc me sy, me fjalë, me krejt çka je,
Sikur don me m' ba marak, e prapë me m' lan rehat s'ke,
Nëse asht dashni, le t'na çojë ku t' dojë, veç m' thuaj që për mu ke le.

Kur vjen ti, m' pret fjalën, krejt menja m' humb,
S'di a je andërr, a naj engjëll që vjen me m' mund,
Veç nji buzëqeshje tande, e m' bahet nata dritë gjithkund.

M' ngucë me fjalë, me sy, me za që m' lodh kandshëm,
Si me m' thanë "t' marr e t' la", por me stil, krejt amblshëm,
Nese kjo asht dashni, le t' bahet realitet, mos t' jetojë permallshëm.

S'dua asgja ma shumë, nëse kjo asht dashni,
As enigmë, as fjalë, veç me ndal kohën e tandes prani,
Të mbesim këtu mes ndjenjave, ne t' dy, n' përjetësi.

◀ Kësisoj, i përqendruar në çdo faqe të librit, në shumë paragrafë, edhe me "drithërima", unë besoj në të gjithë përmbajtjen e librit, në përfundimet që arrijnë autori, dhe e quaj një punë të vyer nga ato që e sollën librin në botimin shqip.

Nuk marrë përsipër të bëj analizën e librit, por të vërtetat e tij i marrë pa ngurrim si të mirëqena, ndonëse, për disa personazhe, janë shumë të dhimbshme, sidomos disa priftërinj që jemi rritur me veprat e

tyre të shkruara, jo ato që flasin për përkatësinë dhe devocionet e tyre fetare.

Librin qëlloi ta lexoja disi paralel me një libër tjetër të "Botime Françeskane", me librin, AUTOBIOGRAFI të At' Marjan Prelaj, OFM, rreth të cilit jam mrekulluar. Kjo ka pak rëndësi.

Por te libri i Imzot Delegatit, të të vërtetat e tij dhe impresionet e marra, më shkoj në mendje disa nga episodet e Luftës civile të vitit 1997 në Shqipëri dhe fjalët e ish Kancelarit austriak Vranicki, që erdhi

O TË MARR, O VDES

Ato flokët tua
Hedhur përmbi shpinë
Ti përkëdhel dua
Vashëz gjeraqinë

Syri yt i shkruar
Ngjyrën marrë qiellit
Më ke përvëluar
Moj rrezja e diellit

Buza jote kuqe
Si qershie e pjekur
E vogla burbuqe
Zemrën ma ke djegur

Të të puth njëherë
Buzë ndezura flakë
Dua të t' marr erë
Të heq k' të merak

Përmbi tëndin gjoks
Kokën të mbështes
Ëmbëlsisht të loz
Mos më lër të pres

I shikoj me ëndje
Të tuat veprime
Brenda zemrës tënde
Peng ke zemrën time

Sa herë shkon e vjen
Me sy m' shigjeton
Do ta gjej folenë
Kot po më mundon

Kur më hedh shikimin
E prek dashurinë
Te ti gjej shërimin
Lule trëndelinë

Me nazet e tua
Më ke lënë pa gjumë
Po më çmend mua
Çdo ditë e më shumë

Moj flokë gështenjë
Derdhur përmbi sy
Dërgomë një shenjë
Vij të rri me ty

Zemrën ma ke marrë
Shpirti për ty m'digjet
Mos më lër të vvarë
Hapmi mike shtigjet

Falmë dashurinë
Mos më lër të pres
Gonxhe në lëndinë
O të marr, o vdes

PLUMBI I TRADHTISË

Një dashuri që si diell shkëlqente
Pasion i flaktë para martesës
Puthje të ëmbla, të lehta prekje
Shpirtërisht mbërthyer në rrethin e jetës!

Një betim, një ëndërr, një i pastër premtim
Rrugën e dashurisë do ndiqnim përjetësisht
Por kjo lidhje do të ishte për amshim
Nga plumbi i tradhtisë u godit pabesisht!

Kthjelltësinë, mbuloi e errëta vranësi
Tradhtia, plaga që shpirtin shkatërroi
Dashuria u shndërrua në egërsirë
I nguli thikën zemrës që atë dashuroi!

Pas martesës, s'mbeti asnjë shpëtim
Përsëritet me ëmbëlsi mbaruan
Urrejtja u ndez, dogji çdo të bukur kujtim
Ditë-netët e zeza të shpirtit filluan!

Ajo që dikur ishte pasion e lumturi
Kthehet në skëterrë mbuluar nga urrejtja
Nga tradhtia u shkatërrua një dashuri
U ndanë rrugët tona, pa na ndarë vdekja!

TROJE SHQIPTARE

O troje shqiptare,
lule shekulllore
çelur mes ferrave të pabesisë!
Sa shumë u dhemb
copëtimi i ILIRISË!

Bashkimin me ty Kosovë
e duam me shpirt,
o lule e bukur maji
që rrezaton çdo ditë!

E vuajtura Luginë!
Për ty qajnë Bujanoci,
Presheva e Medvegjeja,
mbete mes mjegullës
e diellin ta mbulon reja!

Çamëri, moj bijë
nga gjiri mëmë të ndanë,
në ngricë e acar të lanë,
por rrënjët dot s'ti thanë!

Ti Martinaj
në komunën e Gucisë,
rrit djem e vajza të edukuara
me ndjenjën e atdhedashurisë!

O viset e mia!
Ju degët e një trungu
me ëndrra në zemër,
të nënës Shqipëri
doni t' bukurin emër!

O toka ime amtare
je pikë strategjike,
gjithkush të lakmon,
por t' gjunjëzohesh s'pranon!

Duan të t' shfrytëzojnë
e t' shkelin me këmbë,
por shkëmb graniti je
o zonjë e rëndë!

Je lis i fuqishëm
që kurrë nuk rrëzohet!
Ke popullin trim
që për liri flijohet!

Ke besë e nder,
me gjak shqiptari,
s'pranon pranga
t' asnjë barbari!

Ke bij të lindur
në mëmëdheun e tyre,
duan hënë, diellin,
qiellin e kaltër,
natën me yje!

Populli im krenar
zhytur rrënjët thellë në tokë,
ushqyer me gjak e lot,
askush s'ti shkuli dot!

O kombi im i lashtë,
me plagë e dhimbje gjer n' asht,
kompozues i refrenit të pavarësisë,
udhërrëfyes për shqiponjën
e lirisë!

Luftë e Dytë Botërore, nga aleatët tonë të vërtetë, dhe nga fati ynë i keq, me ke na atashuan pas luftës.

Ju ftoj ta blini librin, ta lexoni me kujdes, me mendje të hapur dhe sy kritik, siç na sugjeron famullitari ynë.

Libri ka 195 faqe, kushton 1500 lekë, pra ja vlen.

Leonard Qyteza,
Shkodër me, 25 shtator 2025



**MUNDËSUAN BOTIMIN
VËLLEZËRIT, ZEF,
KRISTJAN E KLAUDIO
PALI, ME BANIM NE
CUNEO, ITALI**

REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia
Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja,
Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza,
Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.